



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Shkenca Juridike”**

- 1. E drejtë publike dhe administrative**
- 2. E drejtë private**
- 3. E drejtë penale**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc. Dr. Hemion Braho

2. Dr. Bledar Mustafaraj

Tetor/2021

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave Juridike me drejtime: a. E drejtë publike dhe administrative b.E drejtë Private c.E drejte penale, ofruar nga Universiteti Privat "Albanian University"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Juridike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave Juridike me drejtime: a. E drejtë publike dhe administrative b.E drejtë Private c.E drejte penale
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 408, datë 26.5.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASH Nr. 385, datë 06.09.2013
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 112, datë 2.11.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vit / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE/8 PAK v.a 2020-2021 7 PAE/8 PAK v.a 2019-2020
18	Numri i studentëve:	18 studentë v.a 2020-2021 34 studentë v.a 2019-2020
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Institucioni jopublik i arsimit të lartë “Albanian University” (i përmendur në vijim me inicialet AU) është licencuar dhe ka nisur veprimtarinë e tij në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 10.04.2004 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “UFO Dental”. IAL ka ndryshuar emrin me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 597, datë 28.5.2009 “Për ndryshimin e emrit të Universitetit Privat “UFO University”” dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 603, datë 24.08.2011, nga “UFO University” në “Albanian University”.

Ky institucion e ushtron veprimtarinë si person juridik, në formën e shoqërisë tregtare “UFO” sh.p.k., me NUIS J82025002B, me seli qendrore të veprimtarisë në Tiranë.

AU përbëhet nga tri fakultete: Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Brenda Fakultetit të Shkencave Shoqërore është ngritur dhe funksionon Departamenti i Shkencave Juridike.

AU është akredituar institucionalisht me vendimin Nr. 01, datë 24.01.2020 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë “Për akreditimin institucional të institucionit të arsimit të lartë, Universitetit Privat “Albanian University”, me kohëzgjatje 3 vite”.

Sa i përket programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile: 1) E drejtë publike dhe administrative; 2) E drejtë private dhe 3) E drejtë penale, objekt vlerësimi, ky program është hapur fillimisht me VKM Nr. 408, datë 26.5.2010, dhe është akredituar me vendimin Nr. 49, datë 19.5.2017 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Programi, objekt vlerësimi, është riakredituar me vendimin Nr. 112, datë 2.11.2019 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, me rekomandime.

Programi, objekt vlerësimi, synon të pajisë të diplomuarit që kanë marrë diplomën Bachelor në Shkenca Juridike apo në fusha të ngjashme, me njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe me aftësinë për të rritur nivelin e kërkimit shkencor apo trajnim profesional në aftësinë ligjore në fushën e secilit prej profileve (*Evidenca 1.5 “Rregullore MSH Shkenca Juridike”, neni 4*).

AU ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin periodik të programit të studimit Master Shkencor në Shkenca Juridike, ku me shkresën Nr. 61/2 Prot., datë 14.4.2021 të kësaj Agjencie ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer lidhur me qëllime të riakreditimit.

Më datë 28.09.2021, ASCAL ka dërguar në institucion draft-raportin e vlerësimit të jashtëm të hartuar nga ekspertët e vlerësimit. Më datë 11.10.2021 institucioni ka sjellë në ASCAL komentet në lidhje me draft – RVJ. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe kanë dhënë argumentet si më poshtë:

Memo

Për Komentin që i përket standardit I.3, kriteri 7, fq. 14, të RVJ, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. Sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, si në RVB, si përgjatë vizitës është evidentuar marrëveshja me Universitetin e Salernos (Itali), por kjo nuk është e mjaftueshme përse i përket avancimit dhe konsolidimit të kurseve të caktuara të ofruara në gjuhë të huaj.

Për Komentin që i përket standardit I.4, kriteri 1, fq. 15, të RVJ, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. GVJ ka konstatuar se Departamenti i Shkencave Juridike (DSHJ) së AU, disponon kapacitetet e duhura akademike dhe burimet e nevojshme në fushën akademike si për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, për të realizuar programin e studimit. Pavarësisht nevojave të departamentit qëndron konstatimi se personeli akademik me kohë të plotë realizon pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore në programet e studimit që ofron fakulteti duke sjellë mbingarkesë mësimore për disa anëtarë të stafit PAE, veçanërisht të pedagogëve të ngarkuar edhe me detyra administrative.

Për Komentin që i përket standardit I.5, kriteri 6, fq. 17, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. Institucioni nuk ka një material specifik mbi kriterin e analizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Departamenti i Shkencave Juridike, bazohet kryesisht në të dhënat statistikore të vijimësisë së studentëve të diplomuar me të cilët edhe Zyra e Këshillimit dhe Orientimit të Studentëve dhe tregun e punës. Në këtë kuadër, GVJ i qëndron konstatimit lidhur me analizën e vlefshmërisë dhe efektshmërisë së marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit

Për Komentin që i përket standardit II.2, kriteri 7, fq. 23, të RVJ, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson pozitivisht shpjegimin e institucionit, duke sjellur edhe ndryshimin e gjetjes në raport. GVJ kishte konstatuar se roli i koordinorit është i parashikuar në aktet rregullative të AU. Këtë funksion e mbulonte aktualisht Përgjegjësi i Departamentit dhe të caktohej një anëtar tjetër departamenti në rolin e koordinorit të programit. Departamenti ka reflektuar këtë ndryshim nga viti 2021-2022.

Për Komentin që i përket standardit II.7, kriteri 3, fq.30, të RVJ, GVJ konstaton dakordësinë e institucionit me këtë gjetje, duke qenë se nuk ka përgjigje.

Për Komentin që i përket standardit III.7, kriteri 9, fq.43, të RVJ, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. Nga GVJ është konstatuar se personeli akademik inkurajon në mënyrë të vazhdueshme studentët të marrin pjesë në konferenca dhe të publikojnë punimet e tyre në revista shkencore edhe me mentorimin e Pedagogëve dhe rrjeteve të tyre akademike-shkencore. Megjithatë, mungon evidenca e mbështetjes financiare apo iniciativave të studentëve apo organizimi i konferencave studentore apo prezantime të vazhdueshme të studentëve përpara trupës akademike të njësisë bazë



Për Komentin që i përket standardit III.3, kriteri 6, fq. 37 të RVJ, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. Në web-site të institucionit referohet mbi portalin www.portal.getty.edu ku ofrohen rreth 100.000 volume librash të vëna në dispozicion nga një sërë universitetesh në mbarë botën nga të cilat 6.400 janë vetëm mbi arkitekturën. Ndërsa në bibliotekën on line www.elsevier.com ofrohen për studentët 46 907 tituj librash dhe 2221 gazeta. Nuk rezulton abonim specifik për këto dy portale. Gjithashtu në RVB referohet portali Questia të cilit i ka mbaruar abonimi. GVJ konstaton këtë si mangësi dhe nënvizon se abonimi në biblioteka elektronike në fushën e së drejtës, do të përmbushte më mirë plotësimin e qëllimeve të programit të studimit.

Për Komentin që i përket standardit III.4, kriteri 5, fq. 38, të RVJ, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. GVJ konstatoi se strukturat dhe njësitë përgjegjëse kanë si qëllim rritjen dhe mbështetjen ndaj personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Në kuadër të projekteve të ndryshme të bashkëpunimit, por edhe në kaudër të marrëveshjeve që ka me institucione të tjera, ka patur mundësinë e rritjeve të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe përdorimit të metodave të reja në mësimdhënie. Megjithatë strukturat përgjegjëse nuk trajnojnë në mënyrë të vazhdueshme personelin me këtë qëllim. Mbetet në përgjegjësinë e personelit akademik që të gjejë mundësitë më të mira që të për rritjen e aftësive dhe metodat e reja për përmirësimin e aftësive akademike.

Për Komentin që i përket standardit III.6, kriteri 6, fq. 41, të RVJ, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. Nga GVJ është konstatuar se Departamenti i Shkencave Juridike, si njësi bazë për realizimin e këtij programi studimi, monitoron procesin e kontrollit të dijeve, përmes ngritjes së “komisionit të monitorimit të provimit”, i cili përbëhet nga 2 pedagogë monitorues (*neni 21 i rregullores së programit, Evidenca 1.5*), duke garantuar një proces transparent dhe sa më akademik, në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij programi studimi. Mungon një udhëzues specifik mbi qasjen etike ndaj detyrave akademike. Në këtë aspekt do të ishte e udhës përpunimi i një dokumenti rregullues mbi qasjen etike ndaj detyrave të ndryshme akademike.

Për Komentin që i përket standardit IV.2, kriteri 3, fq. 47, të RVJ, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson shpjegimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. Nga GVJ është konstatuar që institucioni ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar trajnimin dhe kualifikimin e personelit akademik dhe atij kërkimor-shkencor. Këto trajnime dhe programe janë në harmoni me objektivat që ka marrë përsipër institucioni dhe janë realizuar me trajnues vendas dhe të huaj (*Evidenca 3.8 "Raport vjetor DSHJ 19-20", f. 28-35; Evidencat shitesë 3.a, 3.b, 3.c, 3.d; 3.5.b "Trajnime personeli prof të huaj"; 3.10 "Marrëveshja UNISA AU 19-21"*). Gjithsesi, vetëm këto veprimtari janë të pamjaftueshme, ndaj dhe është rekomanduar shtimi i marrëveshjeve me IAL të huaja, të cilat do të ndihmonin kualifikimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik dhe atij mësimor-shkencor, në përputhje me drejtimit e studimit të këtij programi studimi. Në këto kushte, GVJ i qëndron plotësisht gjetjes së bërë.

Për Komentin që i përket standardit IV.6, kriteri 5, fq. 55, të RVJ, GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron gjetjes së bërë. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit Master Shkencor në Shkenca Juridike. Situata financiare paraqet qëndrueshmëri dhe për ata studentë që do të zgjedhin të ndjekin programet e studimit të ofruar nga Departamenti i Shkencave Juridike. GVJ ka konstatuar se të ardhurat faktike janë siguruar vetëm nga tarifat e shkollimit (*Evidenca "Tabelat përmbledhëse, tabela 18"*). Pikërisht për këtë arsye e duke mbajtur në vëmendje burimet e të ardhurave faktike, vlerësohet nga GVJ shtimi dhe i faktorëve të tjerë në të ardhurat institucionale, sipas parashikimeve të vetë statutit të AU, për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së IAL përballë situatave të paparashikuara të riskut. Përfundimisht, GVJ i qëndron këtij konstatimi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet GVJ) është trajnuar paraprakisht nga ASCAL; ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet RVJ) është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar në institucion. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejt e në mënyrë objektive, performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.



Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Asoc. Hemion Braho, ekspert dhe drejtues i GVJ, dhe Dr. Bledar Mustafaraj, ekspert (Të caktuar me urdhrin Nr. 35, datë 24.5.2021, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë). Gjatë gjithë këtij procesi, GVJ është asistuar nga z. Muhamed Prezja, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion.

Gjithashtu, informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, të zhvilluar në datë 8 Korrik 2021 sipas një agjende gjithëpërfshirëse.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga AU në ofrimin e një programi të mirë Master Shkencor në Shkenca Juridike, gjithashtu jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik, kërkimor dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të juristëve.




SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 112, datë 2.11.2019, janë:


1. Institucioni, të hartojë një plan veprimi deri në vitin 2022, me masa konkrete dhe të matshme për të arritur treguesit strategjikë të zhvillimit institucional.
2. Institucioni, të shoqërojë raportet e vetëvlerësimit me analizë të mangësive dhe shkaqeve të tyre si dhe me masa konkrete për evitimin e tyre.
3. Institucioni, të sigurojë që formimi profilizues që merr studenti gjatë këtij programi studimi të justifikojë shtesën e emërimit të programit të studimit, me tre drejtime.
4. Institucioni, të rishikojë syllabuset e programit të studimit me qëllim bërjen sa më të qartë të kompetencave që studentët marrin nga lënda e caktuar.
5. Institucioni, të hartojë një studim real të nevojave të tregut të punës për këtë program studimi dhe mundësisë së punësimit të studentëve.
6. Institucioni, të sigurojë përputhshmërinë ndërmjet titullarëve të lëndëve dhe angazhimin e tyre në mësimdhënie në këtë program studimi.
7. Institucioni, të përfshijë në këtë program studimi, staf akademik me kualifikimin të paktën Doktor i Shkencave, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
8. Institucioni, të nxisë e mbështesë më tepër përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve të këtij programi studimi në aktivitete kërkimore shkencore.
9. Institucioni, të përmirësojë infrastrukturën e sallave të leksioneve dhe seminareve ku zhvillohet procesi mësimor për studentët e këtij programi studimi, ndriçimin e tyre dhe pajisjen me sisteme ajrimi më cilësore.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Lidhur me rekomandimin e parë, GVJ konstaton se Institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë duke përpunuar një plan veprimi në kuadër të përmbushjes së Planit Strategjik të Zhvillimit të AU, 2017-2020. Në lidhje me strategjinë institucionale, ky dokument detajon në mënyrë të përpiktë aktivitetet, përgjegjësit dhe afatet kohore dhe njësis kryesore mbikëqyr zbatimin e planit të veprimit për të siguruar që rekomandimet për veprimet e duhura të ndiqen për të korrigjuar çdo mangësi të identifikuar dhe siguron një raport progresi (evidenca R.1). *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*



2. Lidhur me rekomandimin e dytë, Departamenti ka angazhuar Grupin e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti në përgatitjen e një raporti të përshtatshëm vetëvlerësimi (*Evidencë R.2*), në përputhje me Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë në AU (*Evidencë 6.4*). Ky raport është përgatitur në përputhje me kërkesat e lëna nga akreditimi i mëparshëm dhe ka shërbyer gjithashtu në kuadër të përmirësimit të cilësisë dhe autoanalizës institucionale. Të dhënat janë përfshirë nga databasa e Departamentit, nga gjithë personeli akademik, personeli ndihmës akademik, studentët aktual, alumni, si dhe tregu i punës, ndryshe nga më parë që vetëvlerësimi kufizohej nga disa aspekte. *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*
3. Lidhur me rekomandimin e tretë, GVJ u sqarua gjatë vizitës se ndarja në tre profile ndjek modelet e mira ndërkombëtare ku profilizimi realizohet gjatë zhvillimit të kurrikulës së Masterit Shkencor në Shkenca Juridike me lëndë të profilizuara, si edhe në përfundim me lëndët e dedikuara një nga tre profileve (*takimi me autoritetet drejtuese të departamentit*). Kjo specializon studentin në një fushë të caktuar, por nuk e kufizon gjithashtu më vonë në përzgjedhjen e një karriere të orientuar ndryshe nga profili i studimit. Në nivel kreditesh, kurríkula e programit të studimit siguron formim profilizues për vetë faktin që për secilin profil studenti siguron më shumë se 60 kredite ECTS, aq sa shërbejnë për një vit akademik (*Evidenca R. 3*). *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*
4. Lidhur me rekomandimin e katërt, njësia bazë ka ndërmarrë iniciativë mbi përditësimin dhe përmirësimin e syllabuseve, ku në fund të vitit akademik drejtuesi i personelit akademik në bashkëpunim me grupin e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti angazhohen në rishikimin e programeve lëndore dhe dosjet e këtyre ndryshimeve arkivohen. Në këtë mënyrë kurríkulat si edhe syllabuset, përmbajnë të gjithë komponentët e nevojshëm dhe informacionin mbi organizimin e secilës lëndë, modul apo praktikë. Këto përditësohen duke iu referuar literaturës së detyruar apo ndihmëse vendase dhe të huaj të azhornuar në 5 vitet e fundit me profilin specifik lëndor (*Evidenca 2.2*). Për këto arsye GVJ gjykon se është refleuar në mënyrën e duhur mbi këtë rekomandim. *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*
5. Lidhur me rekomandimin e pestë, Institucioni ka reflektuar pozitivisht mbi këtë rekomandim duke realizuar një studim tregu të plotë duke përdorur të dhëna dhe analiza të ndryshme, falë edhe rekomandimit të Bordit të Akreditimit të ASCAL (*Evidenca 1.1*). Ky studim fokusohet tashmë në mundësitë e punësimit të studentëve në nivel rajonal, kombëtar e ndërkombëtar, kërkesat e punëdhënësve, si edhe orienton rreth hapjes së programeve të reja apo modifikimit të atyre aktuale. *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*
6. Lidhur me rekomandimin e gjashtë, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike ka kualifikimet e duhura në nivelin e kërkuar për të menaxhuar modulet e lëndëve me të gjitha specifíkat e tyre. Ata mbajnë titujt dhe



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Shkenca Juridike”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Shkenca Juridike me drejtime, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Juridike në Albanian University (AU) i cili lidhet më së shumti me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit. Këta elementë shprehen qartë në planin strategjik të zhvillimit të AU. Programi siguron një kombinim gjithëpërfshirës të disiplinave ligjore duke u fokusuar në elementët kryesorë si doktrinarë, ashtu dhe praktikë me në fokus tregun e punës dhe kapacitetet e brendshme të Fakultetit.
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ekzistenca e Planit Strategjik të AU-së, ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm, të planifikuar e të mirë menduar të zhvillimit të programit të studimit si edhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen. Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ndihmojë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Programi ofrohet në gjuhën shqipe.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programet e studimit të ofruara nga AU, bazuar në aktet themelore akademike (Statuti dhe Rregullorja e përgjithshme), mundësojnë formimin e vazhdueshëm të studentëve për të kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë dhe qytetërimit (<i>Evidence 1.4 “Statuti”</i>). Misioni i institucionit i parashikuar në Statutin dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit të Institucionit 2017-2022 (miratuar me vendimin nr.14, datë 03.07.2018 të Bordit të Administrimit dhe vendimin nr.25, datë 03.07.2018 të Senatit Akademik) synon të ndihmojë në zhvillimin ekonomik kombëtar dhe rajonal të vendit (<i>Evidenca 1.1</i>).
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Si rezultat i diplomimit studentët mund të punësohen kryesisht në firmat juridike, sektorin privat në përgjithësi, sektorin gjyqësor si edhe administratën publike. Në këtë drejtim, AU ofron programin e Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Shkenca Juridike duke ndërthurur si teorinë ashtu edhe praktikën e së drejtës vendase dhe asaj ndërkombëtare. Këto element u mundësojnë studentëve të analizojnë praktikën e mira

	doktrinare si teorike, si praktike, duke reflektuar mbi zhvillimet e më të fundit jo vetëm juridik, por në tërësinë e aspekteve shoqërore.			
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Programi i studimit MSH nën vlerësim, përmban lëndë të cilat, sipas tre profileve, synojnë formimin e avancuar në të drejtën publike, të drejtën administrative, të drejtën private dhe të drejtën penale (<i>evidenca 1.1</i>). Ky program studimi mundëson vazhdimësinë në ciklin e tretë të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Bazuar në dokumentet strategjike të AU-së si statuti, Plani strategjik për zhvillim, rregullorja e përgjithshme mund të afirmohet se organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike është bazuar në dokumenta strategjike që orientojnë misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë por edhe formimin e shprehive profesionale, si edhe me metodologjitë shkencore të përgjithshme (<i>evidencat 1.1; 1.2</i>). Strategjia e institucionit prek një sërë fushash të rëndësishme në lidhje me ndërtimin e programit, që kanë të bëjnë me nivelin e mësimdhënies, kërkimin shkencor, specializimin e vazhdueshëm të stafit. Programet e studimit që zhvillohen janë kompozuar në përmbajtjen e tyre për t’u ofruar studentëve njohuri dhe dije bazë si edhe aftësi e kompetenca praktike për përgatitjen e specialistëve të rinj të aftë që ti shërbejnë zhvillimit të sistemit juridik të vendit.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Neni 3 i rregullores së përgjithshme të AU, përcakton konsolidimin e veprimtrisë së strukturave të institucionit, duke respektuar lirinë akademike në funksion të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor (<i>Evidenca 1.2</i>). Realizimi i i këtij parimi mundësohet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit institucional me institucionet brenda dhe jashtë vendit; organet e administratës publike; institucionet e sistemit gjyqësor etj (<i>Evidenca 1.6</i>). Programi i studimit është hartuar në përputhje me prioritetet akademike të përcaktuara në Statutin e Albanian University (<i>Evidenca 1.4</i>).
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit	Programi i studimit Master Shkencor në Shkenca Juridike ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore si njësi kryesore dhe Departamenti i


të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Shkencave Juridike si njësi bazë akademike. Në Planin Strategjik të Departamentit të Shkencave Juridike janë përcaktuar parimet mbi të cilat mbështetet puna e njësisë bazë, objektivat akademike dhe ato të kërkimit shkencor, bashkëpunimin me institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit që ofrojnë programe të njëjta studimi (Evidenca 1.3)			
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	Statuti i institucionit (neni 16) ka përcaktuar rolin e njësisë bazë të AU, të cilat janë përgjegjëse për programet e studimit që ofrohen, duke synuar bashkërendimin, organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore për programet respektive të studimit (Evidenca 1.4). Programi i studimit ka parasysh strategjitë kombëtare të zhvillimit ekonomik, social, politik dhe mjedisor. Kërkesa e tregut të brendshëm për shërbimin e juristëve në fushën e biznesit është gjithmonë në rritje. Investimi në kapitalin njerëzor i pajisur me kompetenca juridike me drejtim biznesi është qëllimi kryesor i këtij program studimi. Një investim në këtë fushë është gjithashtu edhe në interesi kombëtar, duke pasur parasysh tendencën e shumë të rinjve që kërkojnë të emigrojnë drejt tregut botëror të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Në rregulloren e Programit të studimit MSH në Shkencë Juridike është e përcaktuar qartë organizimi i punës mësimore, shkencore, financiare dhe administrative që janë dhe infrastruktura bazë e realizimit të procesit formues për studentët. Ky program përbëhet nga lëndë dhe module, ku janë të përcaktuara qartë qëllimet, objektivat, dijet dhe kompetencat profesionale që studentët përfitojnë në përfundim të kursit. Bashkësia e këtyre kompetencave është thelbi i programit e cila sipas studimeve të tregut përputhet me atë të kërkesës së tij. Ai ofrohet në module të veçanta dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Objektivat e përcaktuar në rregulloren e programit janë sintetizuar në planet mësimore dhe syllabuse e lëndëve (evidenca 1.5). Strategjinë për Zhvillimin Institucional 2017-2022 AU e ka bërë publike në faqen web: (http://albanianuniversity.edu.al/wpcontent/uploads/2017/04/STRAT_EGJ_1-E-ZHVILLIMIT-INST.AIJ20_17-2022-1_.pdt).

<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka kryer kërkimet e duhura sa i përket tregut kombëtar e ndërkombëtar të punës për programin e studimit, objekt vlerësimi. Studimi mbështetet në të dhëna statistikore, etj., që tregojnë mundësitë reale të studentëve që ndjekin këtë program studimi për t'u punësuar në ata sektorë apo organe shtetërore e organizma të ndryshëm ku gjen zbatim fusha e drejtësisë (<i>Evidenca 1.1</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat e këtij programi studimi janë të përcaktuara në rregulloren e programit përmes parashikimit të elementeve dhe strukturës së planit mësimor (<i>neni 6, evidenca 1.5</i>). Struktura e planit mësimor përbëhet nga lëndët bazë, të cilat synojnë ofrimin e njohurive për përgatitjen metodologjike për studentët; lëndët karakterizuese të programit, të cilat synojnë njohuri specifike në fushën e së drejtës; lëndët ndërdisiplinore, pjesë e të cilave janë dhe lëndët me zgjedhje; lëndë plotësuese, pjesë e të cilave është praktika profesionale dhe; detyrime përmbyllëse, që lidhet me përgatitjen e tezës së diplomës ose provimit përfundimtar (<i>Evidenca 2.1</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit MSH në Shkenca Juridike është ngritur mbi bazën e kërkesave të tregut shqiptar dhe ndërkombëtar, me qëllimin për të përgatitur profesionistë në fushën e drejtësisë. Programi ofrohet në module të veçanta dhe vlerësohet në kredite sipas sistemit ECTS si dhe mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit vetë e të praktikave të vendeve evropiane. Elementet e programit janë të njëjtë me programe të tillë të ofruar nga institucione të huaj (<i>Evidenca 1.5, neni 4</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikave të mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar i cili është harmonizuar me direktivat e BE-së për profesionet e rregulluara. Ky program studimi mbështetet në përvojën disavjeçare dhe praktikave të mira të vendeve evropiane, veçanërisht Italisë (<i>takimi me drejtuesin e departamentit</i>). Elementet e programit përpiqen të sigurojnë një praktikë të mirë dhe më tepër mundësi për studentët që e ndjekin atë.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Ky program studimi parashikon kryerjen e praktikës profesionale (<i>Evidenca 1.5</i>). Praktikave kryhen në institucionet me të cilët janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi (<i>Evidenca 1.6</i>). Programi përfshin dhe një lëndë të posaçme për këtë qëllim, me qëllim aftësimin e studentëve</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i</p>	<p>Profili me karakteristika kombëtare ka bërë që modulet të ofrohen në gjuhën shqipe, duke vështirësuar disi mundësinë e punësimit në organizata ndërkombëtare si edhe mobilitetin përgjatë studimeve. Sa</p>

<p>gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, si në RVB, si përgjatë vizitës është evidentuar marrëveshja me Universitetin e Salernos (Itali). <i>Në këtë pikë, GVJ gjen me vend të rekomandojë që, pasur parasysh nivelin e studimeve të këtij programi si dhe synimet e institucionit lidhur me të, të shihet mundësia për përfshirjen elemente të mësimdhënies në gjuhë të huaj, në drejtim si të aftësisimit të studentëve shqiptarë, por dhe të ndërkombëtarizimit të këtij universiteti.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>AU është angazhuar që dokumentacioni i mbledhjeve, debateve, dhe komunikimeve midis strukturave të tij administrative dhe akademike të mbahet fizikisht dhe elektronikisht. Drejtuesi i Departamentit ruan dokumentacionin kryesor të programit të studimit, gjithashtu nga Databaza e Rektoratit si edhe Dosjet e Departamentit të Shkencave Juridike. Anëtarët e Departamentit mund të kenë akses në këtë bazë dokumentare.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Notë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.4 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike (DSHJ) së AU, disponon kapacitetet e duhura akademike dhe burimet e nevojshme në fushën akademike si për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, për të realizuar këtë program studimi. DSHJ aktualisht ka në përbërjen e tij 32 anëtarë në total (personelit akademik me kohe te plotë dhe me kohe te pjesshme). Personel akademik me kohë të plotë janë gjithsej 10 persona, nga të cilët 6 janë personel akademik me grada shkencore, me përvojë në mësimdhënie dhe punë kërkimore, të cilët bashkërendojnë aktivitetin dhe mbështesin kualifikimin edhe të pjesës tjetër të stafit të fakultetit. Personeli akademik me kohë të plotë realizon pjesën më të madhe të ngarkesës mësimore në programet e studimit që ofron fakulteti dhe <i>kjo sjell mbingarkesë mësimore për disa anëtarë të stafit PAE (spec. Dr. Ismail Tafani -përgjegjës departamenti-, Dr. Fjoralba Zeko).</i> Gjithashtu Institucioni ka personel administrativ 2 anëtarë që është në shërbim të punës mësimore, kërkimore dhe shkencore të të gjithë programeve.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e</p>	<p>Programi studimit Master Shkencor në “Shkenca Juridike” ofrohet nga departamenti i Shkencave Juridike, i cili është një prej katër departamenteve bazë të Fakultetit të Shkencave Shoqërore (njësia kryesore).</p>






studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në përbërje të tij njësitë bazë: <ul style="list-style-type: none"> - Departamentin e Shkencave Juridike; - Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative; - Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme; - Departamentin e Anglishtes. Njësitë bazë kanë një bashkëpunim akademik dhe kerkimor shkencor ndërmjet tyre. Programi i studimit MSH në Shkenca Juridike në tërësinë e tij, është në kohezion të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Shoqërore në AU. 			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje	Departamenti i Shkencave Juridike (njësia bazë) ofrohen programin e studimit Bachelor në “Shkenca Juridike” si dhe programe të studimit të ciklit të dytë: Master Profesional në “Shkenca Penale”; Master Profesional në “E Drejta Private” si Master Shkencor në “Shkenca Juridike”. Fusha e programit të studimit nën vlerësim është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit titulluar Departamenti i Shkencave Juridike, i cili bashkëpunon me njësi të tjera brenda fakultetit dhe AU. Po kështu dhe fushat specifike të programit që kanë të bëjnë me aftësimin e studentëve në sektorin privat dhe në atë publik të cilët do të jenë në gjendje të japin mendime juridike, të hartojnë kontrata, akte që përmban një dosje hetimore, gjyqësore apo përbarimore. Kështu që këto synime përmbushin nevojat e shoqërisë, aktualisht dhe në të ardhmen të zhvillimit të vendit që është në përputhje e në funksion të përmbushjes së qëllimit të departamentit dhe me objektivat e Fakultetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Një përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Realizimi i programit sigurohet nga një staf burimesh njerëzore të kualifikuar si në drejtimin akademik edhe në atë administrativ apo institucional. Në rregulloren e Përgjithshme janë përcaktuar qartë detyrat dhe detyrimet e secilit funksion (evidenca 1.2). Kështu departamenti merr masat që personeli akademik me kohë të plotë (PAE) dhe ai me kontrate (PAK) të realizojnë orët mësimore sipas planit mësimor akademik, personeli ndihmës administrativ të jetë në shërbim





	të vazhdueshëm duke krijuar kushte optimale me qëllim realizimin e programit mësimor dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij. Po ashtu edhe IT-ja siguron mbulimin e shërbimeve online dhe ka patur rol të rëndësishëm për realizimin e procesit mësimor në kohë dhe sipas kërkesave të stafit dhe studentëve .			
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Departamenti i Shkencave Juridike, si njësi bazë ku ofrohet programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe private për realizimin e objektivave formuese për studentët dhe për realizimin e praktikave profesionale (<i>Evidenca 1.6</i>). Marrëveshjet e bashkëpunimit të njësisë bazë synojnë dhe ofrimin e studentëve të mundësisë së punësimit pas diplomimit. Realizimi i mundësisë së punësimit të studentëve mundësohet edhe përmes zyrës së koordinimit dhe mbështetjes së studentëve, e cila ofron informacione për punësimin e studentëve.			
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Institucioni përcakton kryerjen e praktikave profesionale në institucione dhe kompani me të cilat fakulteti ka marrëveshje bashkëpunimi. Sipas departamenteve kanë ndjekë dhe janë caktuar të ndjekin realizimin e praktikave profesionale studentore, ku në përfundim të çdo sezoni praktikash mban të dhëna mbi përfitimet e arritura të studentëve nga këto praktika. Në funksion të realizimit të praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit, AU, për të gjitha bashkëpunimet me aktorë të huaj apo të vendit në fushën përkatëse ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ku janë përcaktuar qartë shkëmbimet e praktikave mësimore dhe shkencore në funksion të stafit akademik dhe të formimit të studentëve.			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqytjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.				
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional AU ka evidentuar një bashkëpunim me Universitetin e Salernos në Itali. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Departamenti i Shkencave Juridike bashkërendon aktivitetet kërkimore me Universitetin e Salernos në projektin EU WEB EU-WESTERN BALKANS (Cooperation on Justice and Home Affairs) (<i>Evidencat R.1, R.2</i>).			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Institucioni nuk ka një material specifik mbi këtë kriter. Departamenti i Shkencave Juridike, bazohet kryesisht në të dhënat statistikore të vijimësisë së studentëve të diplomuar me të cilët edhe Zyra e Këshillimit dhe Orientimit të Studentëve dhe tregun e punës. <i>Në këtë kuadër, do të ishte e këshillueshme të analizohej vlefshmëria dhe efektshmëria e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Veprimtaritë e kërkimit shkencor në AU realizohen mbi bazën e programeve dhe projekteve në përputhje me statutin dhe rregulloret e universitetit, fakulteteve dhe departamenteve. Gjatë vizitës u theksua se AU punon vazhdimisht për rritjen e cilësisë e revistës shkencore OPTIME. Ky konsiderohet si mjet i rëndësishëm drejt ndihmës së dhënë në publikimin e rezultateve kërkimore të stafit. Institucioni ka mbështetur financiarisht stafin në publikimin e rezultateve të tyre shkencore dhe mbështetja kryesore ka konsistuar në pagesat e fee-ve herë pas here për personel të caktuar apo mospagimi i fee kur institucioni është organizator.
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Kërkimi shkencor është nxitës i rritjes së vazhdueshme së Fakultetit. Kërkimi shkencor mbetet një nga shtyllat kryesore ku mbështetet veprimtaria e institucionit si një nga kërkesat kryesore për implementimin e sistemit të Bolonjës në AU i cili synon standardët e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë. AU ka elaboruar një sistem për matjen e cilësisë / sasisë së rezultateve të kërkimit të aplikuar në fakultetet që përfshijnë llojin e rezultateve të hulumtimit dhe caktimin e një sistemi pikëzimi. Ky vlerësim realizohet nga Përgjegjësi i Departamentit sipas një formati udhëzues nga MASR. (evidence VKM Nr. 165, date 21.03.2018 per "Metodologjinë e procesit të vleresimit të veprimtarisë kërkimore shkencore të njërive bazë të IAL-ve") si edhe nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike pranë Albanian University. Përgjegjësia kryesore për rritjen e personelit akademik nga pikëpamja profesionale mbetet individuale.
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Në dokumentat programatikë institucioni e ka në fokus kërkimin shkencor. Gjithsesi vihet re mungesa e planeve të detajuara kërkimore dhe orientimi i stafit për kërkimin që mundet të kryejnë qoftë në grup qoftë në mënyrë individuale. Sidoqoftë institucion ka politika motivuese për të motivuar stafin në kërkimin shkencor në politikat e brendshme.
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Institucioni ka një Këshill Etike që merret me etikën në veprimtarinë, ndër të tjera, edhe të procesit kërkimor. Hartimi i një Kodi Etike sipas praktikave të mira do të kontribonte për mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Njësi kryesore ka miratuar gjithashtu suplementin e Diplomës ku përcaktohen qartë linjat që duhet të ndiqen me qëllim mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe etika e praktikave të mira në veprimtarinë kërkimore (evidenca 3.13). Nuk është evidentuar përdorimi i pajisjeve apo programeve teknologjike në këtë aspekt,


	gjë që ekspozon personelin dhe institucionin ndaj shkeljeve në këtë fushë.			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor duke krijuar mekanizma incentivues në fushën financiare dhe karrierën akademike. Departamenti i ka nxitur studentët për të publikuar në revistën shkencore te Albanian University "Optime".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MSH në Shkenca Juridike me drejtime është në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe vlerësimi në kredite bëhet sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky është i organizuar sipas lëndëve, moduleve dhe krediteve përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor dhe jashtë tij, të ndara sipas formave të mësimdhënies. Ky program studimi është i shtrirë në dy vite akademike, me 4 semestra. Çdo vit akademik ka një ngarkesë prej 60 kredite ECTS. Gjatë të dy viteve akademike programi është i organizuar me lëndë të detyrueshme dhe disa të tjera me zgjedhje, për të cilat zhvillohen provimet në fund të semestrit ose vitit. Më pas përfshihet përgatitja dhe mbrojtja e diplomës. Në planin mësimor parashikohen të gjitha lëndët të cilat zhvillohen gjatë secilit semestër me kreditet dhe orët e ngarkesave përkatëse. Sipas formave të mësimdhënies të parashikuara në planin mësimor ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit për çdo kredit është 25 orë. Plani mësimor hartohet duke u bazuar në VKM Nr. 41 datë 24.01.2018. Ndarja e lëndëve të zhvilluara në këtë program studimi sipas veprimtarive formuese është nga A në E. Kjo ndarje përcaktohet si në vijim: 12 ECTS (10%) në kategorinë e disiplinave të formimit bazë (A); 60 ECTS (50%) në kategorinë disiplinave karakterizuese (B), 18 ECTS (15%) në kategorinë e disiplinave të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese + kategorinë e disiplinave formuese të zgjedhura nga vetë studentët (C); 12 ECTS (10%) në kategorinë e disiplinave plotësuese të njohjes së informatikës dhe praktikës apo metodave të kërkimit (D) dhe 18 ECTS (15%) për punimin e tezës së diplomës (E) (<i>Evidenca 1.5 neni 6</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike është hartuar në përputhje me dispozitat nënligjore në fuqi (<i>Evidenca 2.1</i>). Ky program synon nëpërmjet secilës lëndë apo modul, tu japi studentëve terminologjinë e duhur që i duhet në formimin e tyre profesional. Në syllabusin e lëndëve shprehen qartë dhe në mënyrë eksplicite rezultatet e të nxënit dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të kursit. Qëllimi i këtij programi është t’u japi studentëve njohuritë themeluese dhe shprehitë specifike në fushën e se drejtës, për t’u përballur me shumëllojshmërinë e profesioneve në këtë fushë. Studentët pasi të kenë mbaruar këtë cikël studimi duhet të jenë të</p>





	aftë, të marrin kompetencat dhe ta ushtojnë profesionin e tyre me përgjegjësi si dhe të vazhdojnë studime më të thelluara apo ne ciklin e tretë.
Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Në aktet rregullatore të institucionit (rregullore e institucionit, e fakultetit, e departamentit dhe e programit të studimit) është shprehur qartësisht profili i programeve dhe njohuritë që ato japin. Përditësimi periodik i përmbajtjes së lëndëve/moduleve me literaturën më të fundit bashkëkohore, ndihmojnë studentët të njihen me të rejtat më të fundit në fushën e kërkimit dhe inovacionit. Në syllabusin e secilës lëndë apo modul, tematikat janë bashkëkohore dhe në metodat e mësimnxënies kërkohet nga studentët mendimi kritik për çdo teori dominante të fushës. Në programin e studimit nën vlerësim, përgjatë takimeve në Insitucion, GVJ ka konstatuar se pedagogët zhvillojnë dhe aplikojnë metoda dhe njohuri standarte me qëllimet e përgjithshme formuese të programit duke patur parasysh edhe nevojat e tregut të punës. Tematikat pasurohen me elementë bashkëkohorë duke patur në vëmendje aspektet studimorë të orientuar drejt praktikës sipas standarteve që kërkon një program studimi në nivelin e një “Master të Shkencave” (evidencat 1.2;1.4;1.5).
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Studentët e diplomuar programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike përgatiten për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e së drejtës penale, publike dhe civile. Pedagogët zhvillojnë dhe aplikojnë metoda dhe njohuri të avancuara të cilat kanë për qëllim përputhjen e formacionit të programit me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës. Secila tematikë ka një rëndësi të veçantë dhe trajtohet si një artikull shkencor duke e përditësuar me informacion bashkëkohore. Programi është ndërthur me njohuritë teorike me aplikimin praktik të lidhura direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës (evidenca 1.1).
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Elementët përbërës të strukturës së programit të studimit MSH në Shkenca Juridike janë në përputhshmëri me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. Ai zbaton kërkesat e akteve rregullatore të institucionit, në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe specifike për programin. Çdo modul ka të specifikuar qartë kreditet (ECTS) në përputhje me raportin e orëve teori/praktikë. Kontrollat e dijeve kryhen me anë të detyrave/projekteve të kursit individual ose në grup dhe provimeve të ndërmjetme dhe forma të tjera të cilat janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në syllabuset e lëndëve/moduleve (evidenca 2.2).
Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit MSH SHJ është i organizuar në lëndë dhe module ku përcaktohen qartë veprimtaria formuese e tyre. Sipas rëndësisë që marrin në formimin e studentëve janë të përcaktuara edhe kreditet ose ECTS. Në kriterin 1 të këtij seksioni u evidentua ndarja specifike e lëndëve sipas planit mësimor. Syllabuset e secilës lëndë apo secilit

	modul janë në përputhje me formatet e miratuara nga VKM nr. 41, Dt.24.01.2018: Pika 2.8.			
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Në këto programe studimi janë përcaktuar qartë ngarkesa në kredite e diplomës 18 ECTS (<i>Evidenca 2.1</i>). Për këtë arsye Departamenti ka hartuar një udhëzues për të orientuar studentët në zhvillimin e temës së diplomës duke iu përmbajtur standardeve më të mira ndërkombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Struktura akademike e Fakultetit ndahet në departamente, me Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontrata (PAK) dhe Personel Administrativ. Katër njësitë themelore nën Fakultetin e Shkencave Shoqërore janë: Departamentin e Shkencave Juridike, Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative, Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, Departamentin e Anglishtes. Programi Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” ofrohet rën përgjegjësinë e Departamentit të Shkencave Juridike. Ky plotëson detyrimin ligjor për të pasur numrin prej 7 pedagogësh nga të cilët 3 me tituj dhe grada (6 Dr.) (<i>aneks-tabelat përmbledhëse</i>). Të drejtat dhe përgjegjësitë e cdo njësie janë të përcaktuara në aktet rregullatorë të institucionit.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Departamenti i Shkencave Juridike është struktura përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike dhe plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore për organizimin akademik dhe strukturor të specifikuar. Detyrat e njësisë bazë dhe të drejtuesit të departamentit janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të AU (<i>neni 16 & 30 i Statutit</i>). Drejtuesi i departamentit të Shkencave Juridike, si autoriteti drjetues akademik i kësaj njësie, mban gradën shkencore Dr (<i>parashikuar në nenin 30/4 të Statutit të AU</i>). Detyrat e përgjegjësit të departamentit janë të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme (<i>neni 26</i>).
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Në raportin midis personelit akademik efektiv (PAE) dhe personelit akademik me kontratë (PAK) sipas evidencave rezulton që: Në vitin 2020-2021 rezultojnë 10 PAE (6 Dr, 1 Dr. Proc, 3 Msc) dhe 22 PAK (2 Prof. Dr., 3 Prof. As., 5 Dr., 3 Dr. Proc., 9 Msc) Ndërsa në vitin 2019-2020 9 PAE (5 Dr, 1 Dr. Proc, 3 Msc) dhe 21 PAK (2 Prof. Dr., 5 Prof. As., 4 Dr., 4 Dr. Proc., 6 Msc). Këto evidenca tregojnë që institucioni përmbush aktualisht kërkesat ligjore.
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	

<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe nga evidencat rezultojnë se në Departamentin e Shkencave Civile ka në dispozicion 2 personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, dhe çështjeve të tjera administrative.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Roli i koordinatorit është i parashikuar në aktet rregullative të AU. Këtë funksion e ka mbuluar Përgjegjësi i Departamentit. Numri i vogël i studentëve ka justifikuar këtë zgjedhje. Sipas RVB dhe akteve rregullative rezultojnë se Koordinator i programit të studimit çdo fund semestri ose çdo fund muaj raporton përgjegjësin e departamentit në lidhje me ecurinë e programit dhe realizimin e objektivave të tij, duke u mbështetur edhe në rregulloren e programit, ka një koordinatör i cili mbikqyr dhe supervizon realizimin e programit mësimor si dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Kjo veprimtari do të kryhet në vijim të vitit aktual akademik nga një anëtar stafi ndryshe nga përgjegjësi i departamentit.</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raportojnë në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumentojnë çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.3 Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike, si njësi bazë, ofron informacionin e nevojshëm për studentët dhe stafin akademik. Informacioni lidhet me programet mësimore dhe elementëve të tyre. Cdo program studimor i ofruar nga njësia bazë që ofron programin e studimit MSH në “Shkenca Juridike” përmban emërtimin e lëndëve, krediteve përkatëse, numrin e orëve mësimore në auditor dhe ato të punës individuale të studentëve, titullarët e lëndëve dhe elementët e tjerë të programit të çdo lënde (evidenca 2.2).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Shkenca Juridike” është i organizuar në 2-vite akademike (4 semestra) me 120 ECTS. Viti akademik është i organizuar në katër semestra më 30 ECTS në çdo semestër (evidenca 2.2).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Shkenca Juridike” është i organizuar në lëndë mësimore, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). 2 vite të ndara në katër semestra ku çdo vit ka 60 kredite ECTS (evidenca 2.2)..</p>





<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Çdo lëndë në këtë program studimi përmban qëllimin, objektivat, elementet e kontrollit të dijeve, temat e leksioneve dhe seminareve, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, si dhe informacionet që lidhen me numrin e krediteve, numrin e orëve në auditor dhe individuale të studimit, emrin e titullarit, vitin dhe semestrin ku lënda përkatëse zhvillohet (<i>Evidenca 2.2</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>AU disponon një infrastrukturë të mirë sistemi informacioni në lidhje me informimin e studentëve përsa i përket kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kanalizimi i këtij informacion kryhet në rrugë të ndryshme. Brenda ambjenteve të institucionit gjenden fisha informuese për programin e studimit nën vlerësim. Në "Rregulloren e Regjistruimeve dhe Transferimit të Studimeve" shprehen qartë gjithashtu këto informacione (<i>Evidenca 2.3</i>).</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Informacioni i përcjellë rezulton konform praktikave të mira dhe syllabuset përmbajnë informacionin e nevojshëm për çdo lëndë. Syllabuset e programit të studimit përmbajnë të gjithë komponentët e nevojshëm dhe informacionin mbi organizimin e secilës lëndë, modul apo praktikë (<i>Evidenca 2.2</i>).</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në Shkencë Juridike ka qënë gjithmonë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm nga ana e Departamentit me kadencë vjetore. Në departament, së bashku me grupin e sigurimit të cilësisë, diskutohet përmbajtja e programeve të studimit, problemet që kanë dalë gjatë vitit akademik, si edhe risitë e fundit në fushat përkatëse. Syllabuseve u bëhet përmirësim i vazhdueshëm, në përputhje me udhëzimet e reja që ndryshimet eventuale pasi miratohen në departament e fakultet arkivohen në sekretarinë mësimore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit "Master i Shkencave"/"Master i Arteve" është strukturuar në përputhje</p>	<p>Programi i studimit MSH në Shkencë Juridike përbëhet nga 120 ECTS dhe ngarkesa gjatë një viti të studimeve për një student është</p>




<p>me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>60 (gjashtëdhjetë) ECTS ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë të orarit të punës së studentëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nga të cilat 620 orë studimi gjithsej – 240 orë studimi në formën e leksioneve + 120 orë studimimi në auditor në formën e seminareve + 120 orë në auditor në formën e ushtrimeve + 8 orë në auditor në formën e ushtrimeve + 120 orë studimi në lidhje me praktikë nprofesionale + 12 orë në auditor për temën e diplomës. - orë studimi individuale janë 880 orë gjithsej (<i>Evidenca 1.5 & 2.1</i>).
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Në programin e studimit MSH në Shkenca Juridike me drejtime, pjesa teorike është e gërshetuar me anën praktike e cila mundëson rritjen e njohurive dhe kompetencave të nevojshme për integrimin sa më të mirë të studentëve në tregun e punës. Për të përshtatur sa më mirë programin me tregun e punës, Fakulteti dhe Departamenti kanë kryer edhe studim tregu që ekzaminon edhe programin duke u interesuar për studentët që mbarojnë edhe për orientimin në tregun e punës (<i>evidenca 1.1</i>). Kështu, analiza e tregut shoqërohet edhe me vëzhgimet periodike të evolucionit të kërkesë/ofertës janë bazuar në nevojat që kanë sektori publik dhe privat për burime njerëzore në fushën juridike (<i>Evidenca 1.3</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Refaruar lëndëve mësimore, programi i studimit arrin të përmbush objektivat formues të programit studimor me rezultatet të kënaqëshme të të nxënit. Lëndët e ofruara në tërësinë e tyre duken në përshtatje me orientimin e programit, që mbetet i gjerë duke qenë se ka objektiva formuese në tërësinë e së drejtës.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit MSH në Shkenca Juridike me drejtime është i mirë strukturuar ku lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në simetri të plotë me atë çka kërkon një program i një niveli “master”, jo vetëm në nivel kombëtar por edhe më gjerë. Në dosjen e plotë të programit syllabuset dhe planet mësimore përcaktojnë qartë dhe në mënyrë eksplicite emërtimi, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë të lëndës apo modulit (<i>evidenca 2.1</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve në programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Juridike parashikon se kontrolli i dijeve është i ndarë në: pjesëmarrjen aktive në auditor, detyra përgjatë semestrit, provimin e pjesëshme dhe provimin përfundimtar. Provimi përfundimtar zë 60% të vlerësimit total, ndërsa komponentët e tjerë janë në masën 40% (10% pjesëmarrja në auditor, 10% detyra dhe 20% provimi i pjesshëm). Në përmbajtjen e shumicës së lëndëve janë ore që lidhen me praktikën gjyqësore si p.sh., “Procedura Civile”, “Procedura Penale” etj. Kontrolli i përgatitjes teorike për shumicën e lëndëve të këtij programi studimi zë rreth 60% të vlerësimit total, ndërsa kontrolli i përgatitjes praktike rreth 40%.</p>


	Programi i studimit synon kryesisht formimin e avancuar teorik dhe praktik të studentëve, duke synuar aftësimin e tyre në fushën publike, private dhe penale. Raporti ndërmjet njohuri teorike dhe atyre praktike është i përshtatshëm për këtë program studimi. Organizimi i programit në ECTS mundëson transferimin e studimeve dhe mobilitetin në institucionet brenda dhe jashtë vendit.			
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Stafi akademik përgjegjës për zhvillimin e lëndëve në këtë program studimi përditëson çdo vit akademik programet e lëndëve, duke mundësuar për studentët literaturën më relevante për përfitim të dijeve (<i>evidenca 2.2</i>).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.	Në rregulloren e këtij programi është e përcaktuar qartë që përmbajtja e lëndëve dhe moduleve duhet të garantojnë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për studentët. Përveç kësaj, në syllabuset e lëndëve tek pjesa përmbledhëse dhe rezultatet e të nxënësve, përshkruhet objektivi, synimet dhe kompetencat që studentët përfitojnë në fund të kursit (<i>Evidenca 1.6</i>).			
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Në kuadrin e përmbajtjes së përgjithshme të programit të studimit në fjalë, GVJ konstaton se vijueshmëria është e mundshme në profesionet juridike të cilat kërkojnë formimin e përgjithshëm juridik në fushën e së drejtës civile dhe së drejtës tregtare, pavarësisht se kjo e fundit do të kërkonte ende thellim. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët është përgjegjëse për monitorimin dhe mbështetjen e studentëve në këtë aspekt duke mundësuar dhe lehtësuar edhe më tej aksesin në profesion (<i>evidenca 5.3</i>).			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Numri i paketë të studentëve dhe fakti që në tërësinë e tyre studentët janë tashmë të punësuar, dobësojnë nevojën e thellimit në këtë drejtim. GVJ konstatoi gjatë vizitës sidoqoftë, që AU konsultohet me bizneset private për nevojat e tregut (<i>evidenca 1.1</i>).			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Përmbajtja e lëndëve dhe moduleve në këtë program MSH, krijon një bazë të vlefshme për vijueshmërinë e mëtejshme të studimeve qoftë për specializim për ciklin e dytë qoftë edhe për një formacion të ciklit të tretë			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me

fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike, si njësia bazë në të cilin zhvillohet programi i studimit MSH në Shkenca Juridike ka në përbërje të tij personelin akademik efektiv (PAE) dhe personelin akademik me kontratë (PAK).</p> <p>- Në vitin akademik 2019-2020 janë përfshirë në këtë program studimit 7 pedagogë (PAE), nga të cilët 5 mbajnë gradën shkëncore Dr, një në proces doktorature dhe një ME. Në këtë vit akademik nuk është angazhuar asnjë pedagogë PAE me titull akademik. Personeli akademik më kontratë (PAK) përbëhet nga 8 pedagogë nga të cilët 2 mbajnë titullin akademik Prof, 2 titullin akademik Prof.Asoc, 3 mbajnë gradën shkëncore Dr dhe 1 pedagog me ME. Personeli (PAE) në këtë vit akademik ka realizuar rreth 325 orë në auditor, ndërsa stafi PAK ka realizuar rreth 366 në auditor (<i>evidenca Tabelat përmbledhëse Tabela 4</i>). Për sa më sipër, rezulton që stafi PAE ka realizuar në këtë vit akademik rreth 55% të ngarkesë mësimore.</p> <p>- Në vitin 2020-2021 janë përfshirë në këtë program studimit 6 pedagogë (PAE), nga të cilët 5 mbajnë gradën shkëncore Dr dhe një në proces doktorature. Në këtë vit akademik nuk është angazhuar asnjë pedagogë PAE me titull akademik. Personeli akademik më kontratë (PAK) përbëhet nga 8 pedagogë nga të cilët 1 mban titullin akademik Prof, 3 titullin akademik Prof.Asoc, 2 mbajnë gradën shkëncore Dr dhe 2 pedagogë me ME. Personeli (PAE) në këtë vit akademik, sipas lëndëve me zgjedhje, realizon midis 72% dhe 78% të ngarkesës mësimore (<i>Evidenca 2.1 “Plani mësimor” - aneks, tabelat përmbledhëse</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Në programin e studimit nën vlerësim, departamenti i Shkencave Juridike disponon personelin e kualifikuar për përmbushjen e plotë të këtij programi. Të gjithë pedagogët titullarë (PAE dhe PAK) lëndësh janë me gradën shkëncore ose titull akademik. Dosja e secilit pedagog përgjegjës për lëndën apo module që jepet në këtë program studimi dhe që gjendet në Zyrën e Burimeve Njerëzore, e vërteton këtë evidencë siç u verifikua gjatë vizitës edhe nga GVJ (vizita në zyrën e Burimeve Njerëzore). Një pjesë e tyre kanë kryer kualifikime e specializime jashtë vendit sipas fushave përkatëse dhe disiplinave që mbulojnë. Departamenti ka të detajuara dhe të përshtatura një bazë të dhënash për personelin akademik që realizon programin e studimit (<i>Evidenca 2.1</i>). Ai pasqyron të gjitha ndryshimet që ka personeli akademik efektiv dhe me kontratë gjatë vitit akademik ku zbatohet programi i studimit disponon listën e plotë të pedagogëve akademikë për secilin semestër. Gjithashtu një burim tjetër ku mund të merret</p>

	apo të rejat e transformimeve të tregut të punës si edhe pjesëmarrje nga stafi në panairë të ndryshme të punës (<i>takimi me drejtuesit e fakultetit</i>). Propozimet që rrjedhin shërbejnë për përmirësimin e përmbajtjes së programit.			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Konstatohet se institucioni, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, ka përfshirë dhe marrjen e mendimeve nga studentët. Mendimi i tyre merret kryesisht përmes pyetësorëve dhe fokusgrupeve të targetuara (<i>Evidencat shtesë 8; 8a/8b/8c</i>).			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	Zyra e Karrierës dhe Alumni mban gjithmonë kontakte me studentët e diplomuar. Këto marrin prej tyre informacion dhe propozime për përmirësimin e programeve të studimit të ofruara nga njësia kryesore dhe njësia bazë. Komunikimi realizohet përmes postes elektronike, mediave sociale dhe vizitave të ndërsjella. (<i>Evidenca 5.2</i>). Nuk rezultajnë të evidentuara praktika të administruara për këtë qëllim.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Konform Planit strategjik dhe kërkesave që vijnë nga tregu i punës, programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” zhvillohet këtyre kërkesave, pavarësisht se evidencat mbeten të pakta në këtë aspekt.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në Strategjinë për zhvillim të Institucionit të AU, përcaktohen prioritetet e zhvillimit dhe objektivat kryesorë të studimit. Mund të ishte e udhës një plan zhvillimi strategjik i Fakultetit të Shkencave Shoqërore.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia ushtron kompetenca në bazë të parashikimeve ligjore. Organizon dhe bashkërendon punën insicionale dhe akademike. Realizimi i këtij synimi kërkon zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushat e edukimit, formimit teoriko-profesional, të kërkimit shkencor si edhe në fusha të tjera me interes të ndërsjellë. Marrëveshjet e bashkëpunimit, si në rastin e Universitetit të Salernos (Itali), synohet të intensifikohen dhe konkretizohen në: - Shkëmbim përvoja të stafit akademik; - Pjesëmarrje në kërkime dhe projekte të përbashkëta;

	<p>- Organizim të konferencave apo simpoziumeve shkencore të përbashkëta (<i>Evidenca 1.5 neni 3</i>).</p> <p>Nga vizita në Institucion, liria akademike rezulton e respektuar.</p>			
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit lejon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, organizim të seminareve të përbashkëta me pjesëmarrjen e studentëve të universiteteve bashkëpunues, zotërimi i një prej gjuhëve zyrtare të BE-së, si dhe pasurim të bibliotekës përmes këmbimit të publikimeve (<i>evidenca 2.1</i>). <i>Nga vizita në Institucion rezulton se këto tipologji aktiviteteve mbeten të reduktuara.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Institucioni synon ndërlidhjen e marrëveshjeve në favor të zhvillimit të politikave studimore shkencore rajonale dhe kombëtare. Gjatë vizitës u konstatua angazhim në këtë drejtim (<i>evidenca 1.3</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>GVJ konstatoi se për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore Departamenti është i ndërlidhur financiarisht me veprimtarinë e AU-së dhe <i>të gjitha aktivitetet e ndryshme të zhvilluara mbështeten financiarisht nga institucioni duke qenë se numri i vogël i studentëve nuk i lejon një autonomi financiare në nivel Fakulteti.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	


Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Sipas RVB dhe konstatimeve gjatë vizitës, Institucioni përpiqet të jetësojë lidhjet me universitete të tjera dhe ente të tjera kërkimore shkencore. Marrëveshja me Universitetin e Salernos në Itali ka shërbyer për të krijuar një bashkëpunim mes Departamentit të Shkencave Juridike të këtij Universiteti dhe Departamentit të Shkencave Juridike në AU pikërisht me këtë qëllim.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Përpjekjet janë të vazhdueshme nga ana e njësisë kryesore dhe bazë, për t'iu angazhuar në projekte kërkimore-shkencore, të cilat do të gjeneronin të ardhura shtesë si edhe do të bënin të mundur mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve. Me këtë qëllim, Departamenti i Shkencave Juridike nga bashkëpunimi me Universitetin e Salernos zhvillohet bashkarisht projekti EU WEB EU-WESTERN BALKANS (Cooperation on Justice and Home Affairs) (<i>Evidencat R.4, R.5, R.6</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Ne fushën e programit të studimeve studentët janë të angazhuar të studiojnë praktikën gjyqësore më të fundit dhe aplikimin e parimeve të legjislacionit në raste konkrete. Iniciativat në drejtim të konferencave</p>

	dhe aktiviteve u drejtohen gjithë stafit akademik si edhe studentëve (evidencat 3.5a/3.5b).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Objektivat e përgjithshme mbi të cilat funksionon ky program pasqyrojnë parimet bazë mbi të cilat mbështet IAL-ja, siç është objektivi për përgatitjen me njohuri të avancuara teorike dhe praktike përcaktuar edhe në strategjinë e zhvillimit. Institucioni organizon trajnime për stafin akademik në funksion të metodave inovative të mësimdhënies, përmes trajnimeve dhe workshop. Njësia e Sigurimit të Cilësisë, si një ndër njësitë ndihmëse akademike pranë AU, organizon trajnime për stafin çdo vit akademik (<i>Evidenca 3.5.a; 3.5.b</i>).</p> <p>Trajnimet e organizuara nga kjo njësi ndihmëse akademike (NJSBC) mundesojnë trajnime për stafin në lidhje me: motivimin e studentëve për të rritur efikasitetin e procesit të të nxënës; shkëmbimin e eksperiencës ndërmjet stafit, përdorimin e platformave akademike, teknologjia në mësimdhënie etj (<i>Evidenca 3.5.a; 3.5.b</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike realizon procesin e monitorimit të procesit mësimor, përmes vlerësimit periodik që realizohet nga drejtuesi i departamentit (<i>Evidenca 3.4</i>).</p> <p>Departamenti realizon dhe raportin vjetor mbi vlerësimin e punës akademik dhe shkencore të departamentit, i cili përmban dhe analizën mbi performacën akademike dhe shkencore të stafit akademik që realizon procesim mësimor në këtë program studimit (<i>Evidenca 3.8</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike, si njësi bazë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimit, harton raportin vjetor mbi vlerësimin e punës akademik dhe shkencore të departamentit, i cili përmban dhe analizën mbi performacën akademike të stafit akademik që realizohet dhe përmes vlerësimit nga studentët (<i>Evidenca 3.8</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike, si njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit Master Shkencor në “Shkenca Juridike” informon strukturat përkatëse (dekanin e fakultetit & NJSBC) për përmbajtjen dhe rezultatet e raportit periodik. Stafi akademik informohet për procesin e vlerësimit nga drejtuesi i departamentit dhe pyetorët e realizuara nga studentët (<i>Evidenca R.2</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të stafit akademik, të realizuara përmes procesit të monitorimit nga drejtuesi i Departamentit të Shkencave Juridike, si njësi përgjegjëse për këtë program studimi, janë pjesë e elementeve të analizës vjetore (<i>Evidenca 3.8</i>). Ky vlerësim është në funksion të përmirësimit të procesit mësimor.</p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Shkenca Juridike” në AU, garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional të studentëve, nëpërmjet leksioneve që janë baza teorike dhe seminareve dhe praktikave profesionale. Përveç këtyre formave, institucioni organizon leksione të hapura me të ftuarit e jashtëm apo edhe të vet pedagogëve të brendshëm për tematika që lidhen me fushën e programit të studimit. Procesi mësimor realizohet duke kombinuar disa forma: leksione, seminare, prezantime detyra kursi, seminare dhe ne formën e leksioneve të hapura.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin studimit Master Shkencor në “Shkenca Juridike”, përmes metodave të mësimdhënies, të cilat janë të lidhura dhe me qëllimin dhe objektivat e lëndëve përkatëse, përdor metoda të ndryshme si ato analitike dhe sokratike të transmetimit dhe kontrollit të dijeve. Në varësi të natyrës së lëndëve që ofrohen në këtë program studimi, stafi realizon qëllimin e përmbushjes së objektiveve të lëndëve përmes orëve teorike të zhvilluara në auditor si dhe përmes rasteve praktike të ndërthura me temat përkatëse (<i>Evidencat e syllabuseve</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>AU ka një politikë mbështetëse dhe promovuese ndaj personelit të tij akademik në mënyrë që rrisin aftësitë e tyre profesionale dhe pedagogjike. Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC), si një ndër njësitë ndihmëse akademike pranë AU, siguron mbështetjen e stafit akademik me trajnime, në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies. Kjo njësi organizon trajnime periodike për stafin akademik me tema të ndryshme si p.sh: motivimin e studentëve për të rritur efikasitetin e procesit të të nxënësve; shkëmbimin e eksperiencës ndërmjet stafit; përdorimin e platformave akademike; teknologjia në mësimdhënie etj (<i>Evidencat 3.5.a; 3.5.b</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien e programit të studimit MSH në Shkenca Juridike ka kompetencat e duhura për të realizuar me sukses këtë program. Rekrutimi i këtij personeli është bërë në përputhje me LAL.80/2018: Kreu VI, Neni 64, si dhe duke u bazuar në rregulloren e AU (<i>evidenca 1.2</i>).</p> <p>Në dosjen e gjithsecilit në ZBNJ, gjendet i gjithë informacioni i nevojshëm mbi gradën ose titullin akademik, diplomat dhe</p>

	<p>eksperienca e tij profesionale (<i>vizita në zyrën e burimeve njerëzore</i>). Gjithashtu, eksperienca e personelit akademik që jep mësim në këtë program studimi tregon aftësinë e tij për të qenë kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Në mësimdhënie, ata përdorin metoda auditive dhe vizuale por edhe simulacione të ndryshme në funksion të tematikave dhe profilit të modulit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet NJSBC, vlerëson në mënyrë periodike format e metodat e mësimdhënies të stafit akademik, duke përfshirë në këtë proces edhe studentët. Këto vlerësime shërbejnë për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor (<i>evidencat 1.2; 1.4</i>).</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Në programin e studimit MSH në Shkenca Juridike personeli akademik përdor metoda interaktive në mënyrë që studentët të bëhen pjesë e temës së leksionit. Informacioni i siguruar nga pyetësorët e studentëve dhe stafit akademik konstatohet se ndryshimi I fokusit nga të mësuarit pasiv ku në qendër vendoset lektori në të mësuarin aktiv me fokus studentin dhe rezultatet e të nxënit si dhe lidhja e njohurive me kontekstin real të studentëve nxisin debate dhe diskutime duke e bërë tërheqëse orët e mësimit, në mënyrë që të lidhi njohuritë teorike me praktikën duke nxitur diskutim dhe debat në lidhje me temën e trajtuar.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Stafi akademik në programin e studimit nën vlerësim përdor forma mësimdhënie që inkurajojnë autonominë tek studentit. Sipas përgjigjeve të studentëve gjatë vizitës së GVJ-së rezultoi se ata kanë ndërtuar një marrëdhënie respektit të ndërsjellë me pedagogët. Studentë dhe pedagogë shkëmbejnë mendime dhe argumente lidhur me çështjet që shtrohen për zgjidhje. Detyrat që iu jepen për tu punuar në shtëpi krijojnë mundësinë e shprehjes së ideve të tyre lidhur me zgjidhjen e çështjeve konkrete që dalin çdo ditë nga studimi i çështjeve në gjykata dhe nga praktika e përditshme që kanë pedagogët në praktiken e tyre profesionale. Syllabuset tregojnë se një nga detyrat kryesore janë përgatitja e kërkesave padive apo studime të thelluara në një temë duke krijuar autonominë të studentit (<i>evidencat e syllabuseve</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.






Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike e zhvillon procesin mësimor në godinën qendrore të AU, biv. "Zogu I", në qytetin e Tiranës, me sipërfaqe 3 996 m². Infrastruktura në tërësi përmban klasa me hapësira të mjaftueshme, të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike. Ambientet janë gjetur të pastra gjatë vizitës në institucion. Klasat janë të pajisura me dritare (<i>evidenca 3.6</i>). GVJ konstaton se pas vizitës së fundit, janë bërë përmirësime në lidhje me kondicionimin e ambjentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ky program studimi zhvillohet në hapësira të përshtatshme, mjaft cilësore dhe të mirëmbajtura. Ambientet si salla leksionesh, salla seminaresh, biblioteka apo facilitate të tjera janë të pajisura me logjistikën e duhur mësimore si pc, projektor dhe janë me komfortet e nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor. Biblioteka është e hapur gjatë ditës dhe studentët mund të aksesojnë kopjet e nevojshme për studimet e tyre (<i>Evidenca 3.8</i>). Sa i përket praktikave, gjatë vizitës u referua se nuk ka një sallë për zhvillimin e gjyqeve imituese, por këta realizohen në klasat mësimore. Praktika zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Laboratorët ndihmës për personelin akademik dhe studentët janë të përshtatshëm. Nevojat e programit të studimit MSH në Shkencë Juridike realizohen nëpërmjet laboratorit të informatikës, me kapacitet 30 persona. I gjithë kampusi AU ka Wi-Fi jo vetëm në laboratorë, por edhe në klasa, si dhe në bibliotekë.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë e paraqitur në secilin syllabus të lëndëve, përbëhet nga botime që përdoren në universitetet publike (<i>Evidencat lëndët e programit MSH</i>). Në literaturën plotësuese rekomandohen dhe tekste të përkthyer nga shtëpi të ndryshme botuese si dhe tekste në gjuhë të huaj. Në bibliotekë gjenden tekste në disa fusha të së drejtës (<i>Evidenca 3.7</i>). Pjesë e bibliotekës janë edhe libraritë online si Questia, ERIC, etj. https://albanianuniversity.edu.al/sq/biblioteka-online/</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>AU zotëron një bibliotekë të krijuar ndër vite dhe me botime periodike, ndër të cilët përfshihen dhe ato në fushën e së drejtës (<i>Evidenca 3.7</i>). Institucioni u vë në dispozicion studentëve një pjesë të teksteve për realizimin e programit mësimor, përveç atyre që mund t'i blejnë në librarinë e shkollës. Pjesë e organikës së institucionit (AU) është dhe shtëpia botuese "Albanian University Press", që bën të mundur, ndër të tjera, edhe publikimin e punimeve të pedagogëve, etj. Biblioteka vë në dispozicion të studentëve botime të ndryshme periodike, në ndihmë të fushës së studimeve. AU boton revistën periodike "Optime", një herë në 6 muaj. Artikujt shkencorë të botuara në këtë revistë shkencore përfshijnë punime të të gjitha fushave.</p>

<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në web-site të institucionit referohet mbi portalin www.portal.getty.edu ku ofrohen rreth 100.000 volume librash të vëna në dispozicion nga një sërë universitetesh në mbarë botën nga të cilat 6.400 janë vetëm mbi arkitekturën. Ndërsa në bibliotekën on line www.elsevier.com ofrohen për studentët 46 907 tituj librash dhe 2221 gazeta. Nuk rezultojnë abonim specifik për këto dy portale. Gjithashtu në RVB referohet portali Questia të cilit i ka mbaruar abonimi. <i>GVJ konstaton këtë si mangësi dhe nënvizon se abonimi në biblioteka elektronike në fushën e së drejtës, do të përmbushet më mirë plotësimin e qëllimeve të programit të studimit.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Infrastruktura laboratorike dhe postet e punës me PC janë në nivel të duhur dhe plotësojnë nevojat e studentëve. Ambientet mund të aksesohen në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>			
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>AU përdor platformën online E-learning në të cilën aksesohet në mënyrë të pavarur nga çdo student dhe pedagog. Nga marsi i vitit 2020, pas shpërthimit të pandemisë Covid-19, Institucioni përshtati mësimdhënien or.-line (Platforma Microsoft Teams). Studentët kanë marrë pjesë në procesin mësimor përmes kësaj platforme si dhe kanë dhënë mendim për efikasitetin e përdorimit të saj (<i>Evidenca shtesë 3d</i>).</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Studentët dhe personeli akademik përdorin rregullisht sistemet e komunikimit të brendshëm për të aksesuar dokumentacionin elektronik si syllabuset, leksionet, detyrat e kursit, et. Mjeti më i përdorur rezultojnë të jetë e-maili.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asistojnë dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Personeli akademik është i mjaftueshëm për t'i ndjekur efektivisht dhe për të udhëhequr në punimet e diplomës. Zyrat përgjegjëse përcaktojnë në mënyrë të qartë informacionin në lidhje me temën e diplomës. Departamenti përcakton pedagogun udhëheqës sipas kriterëve të akteve të brendshme të institucionit, i cili udhëheq studentin gjatë këtij procesi (<i>Evidenca 1.5</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies,</p>	<p>Në institucion është ngritur dhe funksionon, që në fillimet e tij, një Zyrë për Sigurimin e Cilësisë, si njësi përgjegjëse për të ndihmuar dhe kontrolluar në garantimin e përmbushjes së standardeve në këtë</p>






<p>koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>drejtim. Institucioni organizon trajnime për stafin akademik në funksion të metodave inovative të mësimdhënies, përmes trajnimeve dhe workshop. Njësia e Sigurimit të Cilësisë, si një ndër njësitë ndihmëse akademike pranë AU, organizon trajnime për stafin për cdo vit akademik (<i>Evidenca 3.5 a/b</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si një ndër strukturat ndihmëse akademike të AU, në bazë të Statutit (neni 64) dhe rregullores së përgjithshme (neni 14) është njësi përgjegjëse për monitorimin akademik dhe administrativ të proceseve të sigurimit të cilësisë. Kjo njësi organizon për cdo vit akademik trajnime në kuadër të zhvillimit dhe kualifikimit të mëtjshëm të stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Trajnimet e zhvilluara për gjatë vitit akademik 2018-2019 dhe 2019-2020, të organizuara nga kjo njësi ndihmëse akademike (NJSBC) janë në lidhje me tematikat: motivimi i studentëve për rritjen e efikasitetit në procesin e të nxënës; shkëmbimi i eksperiencës ndërmjet stafit, përdorimin e platformave akademike, teknologjia në mësimdhënie etj (<i>Evidenca 3.5 a/b</i>).</p> <p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore mbështet zhvillimin e mësimdhënies nëpërmjet metodave inovative dhe shërbimet IT.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtjshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në tërësinë e aktiviteteve të AU një vend të rëndësishëm zë rritja e vazhdueshme e nivelit kërkimor-shkencor të pedagogëve me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit dhe përfshirja e tyre në projekte të ndryshme të sipërmarrjeve private, institucioneve shtetërore, dhe organizmave ndërkombëtare trasmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi (<i>evidenca 3.5 a/b</i>). Kjo përbën bazën për rritjen e vazhdueshme të personelit në fushën e mësimdhënies (<i>evidenca 3.8</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse kanë si qëllim rritjen dhe mbështetjen ndaj personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Në kuadër të projekteve të ndryshme të bashkëpunimit por edhe në kuadër të marrëveshjeve që ka me institucione të tjera ka patur mundësinë e rritjeve të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe përdorimit të metodave të reja në mësimdhënie. <i>Megjithatë strukturat përgjegjëse nuk trajnojnë në mënyrë të vazhdueshme personelin me këtë qëllim. Mbetet në përgjegjësinë e personelit akademik që të gjejë mundësitë më të mira që të për rritjen e aftësive dhe metodat e reja për përmirësimin e aftësive akademike.</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për</p>	<p>Stafi akademik dhe mbështetës në programin MSH në Shkencat Juridike me drejtime janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit, si edhe për monitorimin e korrektësisë dhe cilësisë në</p>

përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	zbatimin e programit nëpërmjet vlerësimit të studentëve dhe vlerësimit të kolegëve. Lektori i lëndës në zbatim të detyrimeve të lëndës përkatëse i referohet planit mësimor të programit të studimit si dhe në mënyrë të veçantë syllabusit të lëndës përkatëse. Në fillim të vitit akademik lektori i lëndës ka të drejtë të përmirësojë syllabusin e lëndës deri në masën 20%.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Departamenti i Shkencave Juridike realizon procesin e monitorimit të procesit mësimor, përmes vlerësimit periodik që realizohet nga drejtuesi i departamentit (Evidenca 3.4). Njësia bazë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit MSH në “Shkenca Juridike”, realizon në mënyrë periodike hartimin e raportit vjetor për vlerësimin e punës akademik dhe shkencore të departamentit. Raporti vjetor përmban një analizë të detajuar mbi performacën akademike dhe shkencore të stafit akademik që realizon procesin mësimor në këtë program studimit. Kjo analizë realizohet përmes vlerësimit të realizuar nga raporti i vetëvlerësimit të realizuar nga pedagogët, pyetsorëve të studentëve dhe vlerësimit nga drejtuesi. Komponentë të vlerësimit të performancës së stafit janë të lidhura me realizimin i procesit mësimor në auditor dhe përdorimin e literaturës bashkohore në funksion të procesit mësimor (Evidenca 3.8). Personeli ndihmës akademik është në funksion të realizimit të procesit mësimor, duke ndihmuar stafin akademik dhe studentët në përmbushjen dhe realizimin e objektivave të programit të studimit Master Shkencor në “Shkenca Juridike”			
Kriteri 8. Institucioni, në kuader të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	AU realizon leksione të hapura me pedagogë të ftuar. Këta lektorë mund të jenë personalitete të fushës në Shqipëri por edhe lektorë të ftuar nga universitete të huaja. Në lidhje me këtë të fundit AU ka një eksperiencë mjaft të mirë dhe të pasur. Keto shkëmbime eksperiencë i shërbejnë edhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë e mësimdhënies dhe përmirësimin e saj si edhe përdorimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies (evidenca 1.7).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.5
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të	Kriteret dhe mënyrat e testimit të njohurive janë të qarta dhe të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit dhe në çdo syllabus lënde. Ato njihen nga studentët, qoftë kontrolli i vazhdueshëm qoftë

posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	forma e zhvillimit të provimit përfundimtar. Në fillim të çdo semestri akademik, stafi informon studentët për përmbajtjen dhe elementet e përbërës të çdo lëndë, duke mundësuar marrjen e informacionit të nevojshëm paraprak nga studentët. Në këtë program studimi elementet e domosdoshëm për ofrimin dhe kontrollin e dijeve të studentëve si dhe literatura përkatëse është e lidhur me njohuritë që priten të merren nga studentët (<i>Evidenca 1.5</i>).		
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi në Institucion rezulton se Studentët e kanë të qartë informacionin në lidhje me metodologjinë e vlerësimit dhe ka një uniformitet midis syllabuseve përsa i përket mënyrës së zhvillimit të provimeve dhe kryerjes së vlerësimit të ndërmjetëm. Ky informacion aksesohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me strukturat e posaçme si sekretaria e studentëve apo departamenti përkatës.		
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Elementet e programit mësimor të çdo lëndë janë: numri i orëve mësimore në auditor dhe orët e studimit individual, të shprehura në formën e krediteve ECTS. Në bazë të nenit 9 të rregullores së programit të studimit, 1 ECTS përbëhet nga 25 orë pune mësimore e ndarë në 10 orë pune në auditor dhe 15 orë pune të pavarur të studentit. Syllabuset e lëndëve përmbajnë; qëllimin/dhe objektivat e lëndës; konceptet themelore mbi të cilat ndërtohet programi mësimor; temat mësimore të leksioneve dhe seminareve; literaturën bazë dhe të këshillueshme; metodologjinë e mësimdhënies, format e kontrollit të dijeve të përcaktuar. Format e kontrollit të dijeve janë të ndara në komponentët: në: 10 % pjesëmarrje aktive në auditor, 10% - 20 detyra përgjate semestrit, 20% provim përgjate semestrit dhe 60% provimi përfundimtar. Kontrolli i dijeve realizohet përmes provimeve me shkrim dhe detyrave të kursit të përcaktuara nga pedagogët përkëtës të lëndëve (<i>Evidenca 1.5</i>).		
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi i studentëve lidhur me dijet, njohuritë e marra dhe aftësite profesionale për modulin përkates zhvillohet i ndarë në disa faza: a. Kontrolli i fazës së parë përfshin kontrollin gjatë procesit mësimor, ku kontrolli i dijeve realizohet përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentit në leksione, seminare, ushtrime, detyra me shkrim (provime ndërmjetëse, detyrat e kursit, praktikën mësimore, etj) – 40%. b. Kontrolli i fazës së dytë përfshin kontrollin nëpërmjet provimit përfundimtar - 60% (<i>Evidenca 1.5</i>).

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Rregullorja se programit të studimit Master Shkencor në “Shkenca Juridike” me drejtime, përcakton procedurat e kontrollit të dijeve të studentëve, proces i cili realizohet përmes transparencës (neni 23, <i>evidenca 1.5</i>). Studentët janë të njohur me rregulloren e programit të studimit dhe në mënyrë specifike dhe me procedurat e zhvillimit të provimeve apo testimit të njohurive.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike ngre komisionin përkatës të provimit të cdo lënde, i cili përbëhet nga së paku dy pedagogët që zhvillojnë procesin mësimor dhe që janë përgjegjës për vlerësimin e tezës së provimit. Komisioni iurvejimit të zhvillimit të provimit, i cili përbëhet nga 2 pedagogë, është përgjegjës për monitorimin e provimit dhe respektimin e procedurave të provimit, duke mundësuar eliminimin e formave të kopjimit apo mos kryerjes së provimit individualisht dhe në mënyrë të pavarur nga studentët (neni 22 i rregullores se programit). Provimet realizohen në formën e sekretuar dhe cdo tezë provimi përmban një numër të kodifikuar, i cili deshifrohet vetëm pas procesit të korrigjimit nga pedagogët. Procesi i kodifikimit është një proces transparent dhe asistohet dhe punonjësit ndihmës akademik të departamentit</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Stafi akademik i këtij programi studimi informon studentët për rezultatet e provimit, proces i cili realizohet dhe me mbështetjen e stafit ndihmës akademik. Tezat e korrigjuara të provimit përmbajnë pikët e fituara nga studentët dhe komentet përkatëse të nevojshme për një informim sa më korrekt dhe akademik të studentëve. Studentët kanë të drejtë të njihen me tezën e provimit dhe në rast se duhen informacioni apo shpjegime më të detajuara në lidhje me vlerësimin, sekretari kontakton pedagogun përkatës (<i>evidenca 1.5</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike, si njësi bazë për realizimin e këtij programi studimi, monitoron procesin e kontrollit të dijeve, përmes ngritjes së “komisionit të monitorimit të provimit”, i cili përbëhet nga 2 pedagogë monitorues (neni 21 i rregullores së programit, <i>evidenca 1.5</i>), duke garantuar një proces transparent dhe sa më akademik, në funksion të përbushjes së qëllimit të këtij programi studimi. Mungon një udhëzues specifik mbi qasjen etike ndaj detyrave akademike. Në këtë aspekt do të ishte e udhës përpunimi i një dokumenti rregullues mbi qasjen e tike ndaj detyrave të ndryshme akademike.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit MSH në “Shkenca Juridike” ka të përcaktuar mënyrën e organizimit të provimeve; afatin e korrigjimit të provimeve dhe; dhënien e rezultateve përkatëse për studentët, përmes sekretarisë mësimore (nenet 18-24, <i>evidenca 1.5</i>).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje</p>	<p>Institucioni dhe departamenti përkatës mundëson njohjen e studentëve me rezultatet dhe tezën e provimit. Në cdo rast që studentët kërkojnë një ballafaqim me pedagogët që kanë realizuar procesin e korrigjimit, atyre</p>





me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	ju vihet në dispozicion teza dhe cdo informacion tjetër shtesë i lidhur me këtë proces.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Procesi i ankimit të studentëve për mos dakortësinë me rezultatin e provimit, realizohet nga departamenti, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e programit. Drejtuesi i departamentit siguron ngritjen e komisionit përkatës të rivlerësimit, në përbërjen e të cilit mund të jetë dhe pedagogu që ka rezlizuar korrigjimi. GVJ, në takimin që realizoi në institucion me drejtuesin e departamentit, u informua që një procedurë e tillë nuk ishte kryer asnjëherë, pasi nuk kishte raste që studentët të kishin kërkuar rivlerësim të tezës së provimit (<i>minutat e takimit të realizuar në institucion me drejtuesin e departamentit</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Planet mësimore dhe programet e lëndëve kanë synim kryesor aftësimin teorik dhe praktik të studenteve. Departamenti që është përgjegjës përfshin në analizën vjetore edhe atë të syllabuseve, sipas procedurave përkatëse dhe në kohë të mjaftueshme përpara fillimit të procesit mësimor, në mënyrë që të reflektohen ndryshimet e nevojshme. Syllabusi paraqitet nga titullari i lëndës, i cili ka të paktën gradën “Doktor i Shkencave”. Analiza e syllabusit merr parasysh të gjithë elementët e tij thelbësorë duke u ndalur në përputhjen e plotë të tij me planin mësimor, bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi, aktet rregullatore të miratuara nga IAL-ja si dhe kërkesat të tregut të punës. Lëndët ndahet në dy pjesë, në pjesën e parë jepen njohuri të përgjithshme, në pjesën e dytë jepen aftësi të veçanta duke përfshirë në disa raste edhe elementë kërkimorë.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në aspektin formal, në syllabuset e lëndëve për programin e studimit MSH “Shkenca Juridike” gjenden të pasqyruara elementët në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, duke theksuar përshkrimin dhe objektivat e lëndës; format e mësimdhënies dhe të kontrollit e vlerësimit të studentëve për lëndën, përmbajtjen e temave dhe çështjet kryesore brenda tyre dhe literaturën e detyruar dhe ndihmëse. Përgjatë programit, lëndët ndërlihen me njëra tjetrën në kuptim logjik drejt thellimit dhe specifikimit të dijeve,
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde,	

<p>analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>duke ofruar kryesisht lëndë të përgjithshme në tre semestrat e parë e në vijimësi, me lëndët më të specializuara.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në fund të lëndës, testohen aftësitë e fituara nga studenti nëpërmjet testimit me shkrim ose me gojë, një temë projekti, rezultatet nga udhëheqesi i praktikës profesionale dhe të gjitha këto grumbullohen në kompetencat e aftësitë personale të studentit</p> <p>Në përmbylljen e çdo kursi, personeli akademik analizon realizimin lëndëve/moduleve dhe evidenton çështjet më të rëndësishme që lidhen me temat e këtij kursi. Personeli akademi bën një përmbledhje të provimit, zbatimin e tyre në praktikë si dhe u demonstron atyre raste praktike studimi nga eksperiencia e tij. Analizimi i programit në përfundim të tij, temave të leksioneve e seminareve dhe javëve mësimore të përcaktuara sipas planit kalendar, bëhet me qëllim evidentimin e problematikave që lidhen me realizimin e tyre si edhe orientimin e studentëve. Kjo i shërben fokusimit si në përvetësimin e përmbajtjes së programit, ashtu dhe për t'u orientuar më mirë në lidhje me përmbylljen e programit me provimin përfundimtar, sipas përcaktimeve aktet rregullative të brendshme përkatëse (<i>evidencat 1.2; 1.5</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike, si njësi bazë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi, realizon aktivitete ekstra-kurrikulare, përmes leksioneve të hapura për studentët. Këto leksione të hapura mundësojnë për studentët informacione dhe njohuri mbi zhvillimet juridike në institucionet e administratës publike (organizuar në nëntor 2019); informacion dhe njohuri në qasjen e katalogëve online/katalogë të digjitalizuar të bibliotekës; përdorimin dhe aksesin në e-bibliografi (nëntor 2018) (<i>evidencat 1.7; 3.9</i>). Këto aktivitete pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit të Shkencave Juridike (<i>Evidenca 3.8</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Metodat e mësimdhënies janë në funksion të realizimit të objektivave të lëndës dhe qëllimit të tyre. Format e zhvillimit të procesit janë në auditor në formën e leksioneve, seminareve dhe ushtrimeve në raportet 2.5 leksione; 1 seminar dhe 1 ushtrime (<i>Evidenca 2.1</i>).</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga analiza e syllabuseve, duke u nisur edhe nga numri i kufizuar i studentëve në klasë, është plotësisht e mundur të testohen metodat e reja të mësimdhënies sidomos në orën seminareve duke nxitur studentin për diskutime rreth një teme dhe duke punuar individualisht.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Institucioni mundëson zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies, përmes realizimit të trajnimeve të organizuara nga NJSBC (<i>Evidenca 6.8</i>). Gjithsesi kjo qasje mbështetet dhe nga garantimi i infrastrukturës së përshtatshme si salla të modernizuara e të organizuara në hapësira të bollshme, projektorë, laborator IT etj.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Stafi akademik i këtij programi studimi është pjesë e trajnimeve të organizuara mbi metodat inovative të mësimdhënies. Metodat inovativa</p>




	<p>janë në funksion të rritjes së cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Përdorimi i metodave sa më efektive për realizimin e procesit mësimor mundesojnë aftësimin e studentëve.</p> <p>Raportohet se personeli akademik inkurajon në mënyrë të vazhdueshme studentët të marrin pjesë në konferenca dhe të publikojnë punimet e tyre në revista shkencore edhe me mentorimin e Pedagogëve dhe rrjeteve të tyre akademike-shkencore. <i>Megjithatë mungon evidenca e mbështetjes financiare apo iniciativave të studentëve apo organizimi i konferencave studentore apo prezantime të vazhdueshme të studentëve përpara trupës akademike të njësisë bazë.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Institucioni ka lidhur marreveshje me institucione homologe të huaja të arsimit të lartë (<i>Evidenca 3.10</i>) për bashkëpunime akademike dhe shkencore. Në kuadër të këtij bashkëpunimi është mundësuar dhe mobiliteti i studentëve dhe pedagogëve. Departamenti ka lidhur marrëveshje me institucione publike dhe private në vend për zhvillimin e praktikave mësimore, të cilat ndiqen dhe monitorohen nga stafi akademik i këtij programi studimi (<i>Evidenca 1.6</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studentët diplomohen duke mbrojtur një temë diplome. Studentët e regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në Shkencë Juridike diplomohen duke filluar nga muaji korrik i vitit të dytë të studimeve. Departamenti i Shkencave Juridike edhe në Rregulloren e Programit të Studimit ka hartuar procedurën e mbrojtjes së diplomës. Studentët e ciklit të dytë të studimeve mentorohen që nga momenti i përzgjedhjes së temës deri në prezantimin dhe mbrojtjen e saj përpara jurisë (<i>Evidencat 3.11, 3.12</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Strukturat akademike dhe administrative i japin ndihmën e duhur studentit që përgatit diplomën sipas përcaktimeve të rregullores. Strukturat përgjegjëse si Departamenti, Sekretaria Mësimore si dhe të gjithë pedagogët udhëheqës, asistojnë studentet gjatë procesit të diplomimit (<i>Evidenca 2.4</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike,</p>	<p>Kriteret, standardet si dhe procedurat e diplomimit, janë të pasqyruara në rregulloret përkatëse dhe u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet broshurave dhe mjeteve elektronikë. Departamenti propozon një</p>


duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	komision prej tre ose pesë anëtarësh që miratohet nga Dekani i Fakultetit. Ky komision është i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi dhe e njeh atë më së miri.			
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Mënyra dhe hapat që duhen ndjekur për diplomimin shpjegohen në mënyrë të detajuar në manualin e studentit dhe është gjithnjë pjesë përbërëse e prezantimit të fillimit të vitit të dytë akademik ku jepen informacione mbi mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve (<i>Evidenca 5.4</i>). Udhëheqësi i punimit të diplomës orienton dhe ndihmon studentin për përgatitjen e temës së diplomës, dhe është pjesë e personelit të angazhuar të Albanian University me gradë shkencore dhe përvojë në Shkenca Juridike. Institucioni i jep mbështetje studentit në përgatitjen e punimit final duke i vënë në dispozicion udhëheqësin, bazën materiale, aksesin në laboratore apo bibliotekë ndërsa shpenzimet e tjera për procesin kërkimor i mbeten studentit. Në bazë të Rregulloreve por edhe nga pyetjet gjatë vizitës në institucion me stafin dhe studentëve del qartë se udhëheqësi ndjek efektivisht (janë të përcaktuara qartë numri minimal i takimeve midis udhëheqësit dhe studentit gjatë punimit të diplomës) dhe punon ngushtë gjatë përgatitjes së temës së diplomës . Studenti mund ta paraqesë punën për vlerësim përpara komisionit vetëm pas miratimit të udhëheqësit.			
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.				
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.				
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Ka një përcaktim të qartë për mënyrën e vlerësimit nga ana e Komisionit të posaçëm në Rregulloret përkatëse. Në fund të secilës lëndë, studentët vlerësohen me një note që varion nga 0 në 100. Ngarkesa në kredite është 18 ECTS. Secili anëtar i komisionit final voton në mënyrë të pavarur dhe mesatarja përcakton votën finale.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Diploma shoqërohet me suplementin e diplomes. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë si edhe është miratuar nga Ministria e Avsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimeve të Studentëve (QSHA) (<i>Evidencat 3.13 a/b/c</i>). Studentit i vihet në dispozicion nga sekretaria Diploma, lista e notave dhe suplementi i diplomës. Materialet e tjera i vihen në dispozicion nga sekretaria me kërkesë të vetë studentit.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.				
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Sekretaria mësimore e programit të studimit, kryesekretaria e fakultetit si dhe Administratori i përgjithshëm ruan dokumentacionin e studentit dhe paraqet informacion për çdo student nëse kërkohet. Në sekretarinë mësimore të institucionit gjenden regjistrat dhe procesverbalet e vlerësimit të studentëve. Sekretaria mësimore, si një ndër strukturat administrative të institucionit vë në dispozicion të studentit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm.			
	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Nga shqyrtimi i akteve të vënë në dispozicion, rezultojnë që institucioni zotëron të dhënat e duhura në lidhje me numrin e anëtarëve të personelit akademik si dhe të gradave e titujve që këta të fundit zotërojnë. Të dhënat janë të administruara për personelin akademik si dhe për atë ndihmësimor-shkencor dhe administrativ (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabelat 1.1; 1.2; 2.1 dhe 2.2</i>).</p> <p>Të dhënat janë mbajtur në mënyrë të detajuar lidhur me angazhimin e tyre çdo semestër dhe vit akademik (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabela 4</i>).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u panë në zyrën e burimeve njerëzore, sipas përzgjedhjes rastësore, dosje personale të personelit akademik si me kohë të plotë ashtu dhe të pjesshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tyre rezultoi që të dhënat e administruara ishin të plota dhe përfshinin kopje të legalizuara të: jetëshkrimit, dokumentit të identifikimit, diplomës universitare dhe të listës së notave, diploma dhe dokumente të tjerë që vërtetojnë gradat dhe titujt e fituar, kualifikimet e ndryshme, librezës së punës dhe atë shëndetësore e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, etj. (<i>Evidenca shtesë "Minuat e vizitës"</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik kryhet nga institucioni në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 80/2015; kushtet, kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur lidhur me rekrutimin e personelit akademik janë shtjelluar në aktet e brendshme të universitetit (<i>Evidenca 1.4 "Statuti AU", nenet 36-38; Evidenca 1.2 "Rregullore e Përgjithshme AU", neni 30</i>).</p>






<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Procedurat dhe kriteret e posaçme për rekrutimin e personelit, janë hartuar nga IAL në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme të funksionimit të tij. Sipas nevojave të institucionit, kriteret dhe procedurat bëhen publike nga Zyra e Burimeve Njerëzore nëpërmjet shpalljes si dhe nëpërmjet njoftimit në faqen elektronike të institucionit, për Fakultetin ku është përfshirë ky program studimi (https://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-viti-akademik-2020-2021/).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti ka rregulluar në mënyrë të qartë etapat që kanë të bëjnë me procesin e rekrutimit të stafit akademik, përmes procedurave transparente.</p> <p>Procesi i rekrutimit fillon nga përcaktimi i nevojave që ka njësia bazë (Departamenti i Shkencave Juridike), të cilat më pas i përcillen për miratim dhe shqyrtim njësisë kryesore (<i>Evidenca 4.5 "Procedurë rekrutimi"</i>). Dekani i fakultetit ia përcjell në vijim kërkesat rektoratit, i cili përcakton kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurimit (<i>Evidenca 1.4 "Statuti", neni 36; Evidenca 1.2 "Rregullorja e përgjithshme", neni 30/3</i>). Në rast përzgjedhjeje, kandidati fitues fillimisht i nënshtrohet një periudhe prove 3-mujore, në përfundim të së cilës do të vendoset vazhdimi ose ndërprerja e kontratës së punës. Ndjekja e këtyre hapave është konfirmuar dhe nga bisedat e zhvilluara gjatë vizitës në institucion. Marrëdhënia formalizohet nëpërmjet kontratës së punës (<i>Evidenca 4.2 "Kontratë pune PAE"; Evidenca 4.3 "Kontratë pune PAK"; Evidenca shitesë "Mimutat e vizitës"</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Institucioni ka marrë përsipër, evidentuar kjo nga rregullimet e përcaktuar në aktet e brendshme të tij, për mbështetjen dhe aftësimin e personelit akademik (<i>Evidenca 1.4 "Statuti", neni 2, pika i; Evidenca 1.2 "Rregullore e përgjithshme", nenet 2-3</i>).</p> <p>Mjediset e krijuar për stafin drejtues dhe atë akademik, për Qendrën Kërkimore e Shkencore, për stafin administrativ si dhe për sekretarinë mësimore, janë të përshtatshëm dhe me sipërfaqet e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së secilit (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabela 16</i>).</p> <p>Nga vizita në institucion është vërejtur se godina ku realizohet mësimdhënia teorike për këtë program studimi, ka klasa të pajisura me</p>

	<p>mjetet e duhura audio-vizive, salla të përshtatshme konferencash, të cilat lehtësojnë punën e personelit akademik. Klasat kanë nevojë për një sistem më të përshtatshëm ajrimi dhe kondicionimi.</p> <p>Godina ka shërbim interneti <i>wireless</i>, të aksesueshëm për përdorim nga studentët dhe personeli akademik e administrativ i institucionit. Në mbështetje të stafit dhe studentëve funksionojnë shërbimi i fotokopjeve, printimit, etj.</p>				
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni është angazhuar për nxitjen profesionale të personelit, me qëllim krijimin e mundësive për të zhvilluar aftësitë e personelit akademik dhe administrativ dhe fuqizimin e kërkimit shkencor (<i>Evidenca 1.1 “Strategjia e zhvillimit institucional” – objektivat strategjike, pika 3 ‘Kërkimi shkencor dhe inovacioni’; Evidenca 1.3 “Plani strategjik DSHJ 2020-2021”, objektiv 2).</i></p> <p>Universiteti mundëson kërkimin shkencor të personelit akademik nëpërmjet krijimit të mundësive për pjesëmarrje në aktivitete shkencore, mobilitetin, etj. (<i>Evidenca 3.5.b; Evidenca R.4; Evidenca R.5; Evidenca shtesë 2 “Model raport vetëdeklarimi kërkimi shkencor”; Evidenca shtesë 3 “Temat e trajnimit të stafit akademik”</i>). Të dhënat në fjalë mund të konsultohen dhe në faqen online të institucionit: https://albanianuniversity.edu.al/sq/agjenda-e-trajnimit-te-stafit-akademik/.</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet që nga institucioni janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar trajnimin dhe kualifikimin e personelit akademik dhe atij kërkimor-shkencor. Këto trajnime dhe programe janë në harmoni me objektivat që ka marrë përsipër institucioni dhe janë realizuar me trajnues vendas dhe të huaj (<i>Evidenca 3.8 “Raport vjetor DSHJ 19-20”, f. 28-35; Evidencat shtesë 3.a, 3.b, 3.c, 3.d; 3.5.b “Trajnime personeli prof të huaj”; 3.10 “Marrëveshja UNISA AU 19-21”</i>). Gjatë vizitës në institucion u deklarua që trajnimet janë përqendruar kryesisht mbi metodologjinë e mësimdhënies (<i>Evidenca shtesë “Minutat e takimit”</i>). <i>GVJ, gjithsesi, rekomandon shtimin e marrëveshjeve me IAL të huaja, të cilat do të ndihmonin kualifikimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik dhe atij mësimor-shkencor, në përputhje me drejtimit e studimit të këtij programi studimi.</i></p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Institucioni tregon si në pikëpamje formale, ashtu dhe në atë të zbatueshmërisë, se angazhohet në të gjithë drejtimet për të siguruar përmbushjen e plotë të detyrave nga burimet njerëzore që disponon, me qëllim arritjen e objektivave në kuadër të programit të integruar të studimeve. Detyrat e secilit anëtar, sipas stafeve përkatës, janë të mirëpërcaktuar në aktet e universitetit, në përputhje me misionin dhe objektivat që ky i fundit synon të realizojë.</p>				
	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
-------------------------------------	--	--	---	--

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Rezultoni që AU disponon infrastrukturën e nevojshme për plotësimin në mënyrë efektive të programit mësimor, në përputhje me numrin e studentëve, natyrën e programit dhe modulet përkatëse (<i>Evidenca 3.6 "Planimetria e godinës"; Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabela 16</i>).</p> <p>Mësimdhënia për këtë program studimi të ofruar nga Departamenti Shkencave Juridike realizohet në korpusin qendror të universitetit. Vlerësimi është përqendruar pikërisht në këtë godinë, ku u zhvillua vizita nga GVJ si dhe ku ofrohet programi i studimit Master Shkencor në Shkenca Juridike, me profile.</p> <p>GVJ ka konstatuar në godinë një sipërfaqe të mjaftueshme në funksion të sallave për leksione, laboratorë, zyra, etj. Sallat janë të pajisura me ndriçim dhe me aksesorët e nevojshëm teknologjikë për zhvillimin normal dhe bashkëkohor të veprimtarisë për të cilën janë destinuar. <i>Klasat janë të pajisura me dritare, por nuk kanë një sistem të përshtatshëm ajrimi dhe kondicionimi (Evidenca shpeshë "Minutat e takimit")</i>.</p> <p>Institucioni nuk ka në përdorim ndonjë sipërfaqe parkimi. Mungojnë hapësirat e gjelbra. <i>Nga vizita në institucion u konstatua se aksesueshmëria, në kuptimin infrastrukturor, për personat me aftësi të kufizuara, mungon.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion u vërejt se AU ka siguruar pajisje të përshtatshme, në funksion të programit Master Shkencor në përputhje me rregullimet e bëra në nenin 47, pika 4, të statutit të tij (<i>Evidenca 1.4</i>).</p> <p>Ky universitet disponon ambientet e nevojshme për realizimin e programit mësimor Master Shkencor në Shkenca Juridike. Sallat janë të pajisura me pajisjet përkatëse elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të cilat lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies.</p> <p>Në godinë funksionin shërbimi i internetit <i>wireless</i>, i aksesueshëm nga studentët dhe stafi akademik e administrativ.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të</p>	<p>Godina ku zhvillohet programi i studimit përmban laboratorët, sallat e studimit, auditorë të madhësive të ndryshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, orëve praktike, leksioneve të hapura, etj.</p>

përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Ambientet e zhvillimit të leksioneve e seminareve janë me hapësira të mjaftueshme dhe mundësojnë qëndrimin lirshëm të studentëve (<i>Evidenca 3.6 "Planimetria e godinës"</i>). Gjithashtu, janë të pajisura me pajisje kompjuterike, projektorë, etj., dhe lehtësojnë përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies. Ambientet janë të përshtatshme për zhvillimin e leksioneve të hapura dhe për aktivitete të tjera të ngjashme.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Sipas RVB (f. 43), në përputhje me programin e studimit, IAL ka siguruar një laborator të informatikës (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabela 16</i>), me kapacitet prej 30 persona. Në këtë laborator, studentët kanë mundësinë që të kryejnë detyra e punime të ndryshme. Studentët dhe pedagogët, gjatë shfrytëzimit të këtij laboratori, asistohen nga një punonjës IT, që ofron shërbimin e asistencës teknike.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Gjatë vizitës në institucion u referua se gjyqet imituese zhvillohen në një nga klasat (<i>Evidenca shpeshë "Minutat e takimit"</i>), por mungon një sallë e krijuar enkas për këtë qëllim, me mjetet e duhur, në përputhje me programin e studimit, për zhvillimin e gjyqeve imituese. Nga ana tjetër, praktikat profesionale dhe disa veprimtari të tjera praktike realizohen në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe në institucione të tjerë, me të cilët IAL ka lidhur marrëveshje (<i>Evidenca 1.6 "Marrëveshje bashkëpunimi"</i>).			
Shkalla e përmbushjes së tandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, e cila bën pjesë në njësitë ndihmëse të AU (<i>Evidenca 1.4 "Statuti", nenet 9 dhe 12; Evidenca 1.5 "Rregullore MSH Shkenca Juridike", neni 32/3</i>). Biblioteka është lehtësisht e shfrytëzueshme nga të gjithë studentët, si në pikëpamje të parashikimeve të bërë në aktet e brendshme të institucionit, ashtu dhe në atë objektive. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se biblioteka është e vendosur në katin për dhë të godinës, në të cilin kishte lagështirë, gjë për të cilën <i>rekomandohet që ambienti të përshtatet në mënyrë të atillë që leximi dhe ruajtja e teksteve të realizohet në kushte të përshtatshme lagështie.</i>

Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.

Institucioni zotëron një bibliotekë me larmi botimesh, ndër të cilët përfshihen dhe ato në fushën e së drejtës (*Evidenca 3.7 "Lista e titujve në DSHJ"*).

Sipas evidencës 3.8 "*Raporti vjetor DSHJ*" (f. 27), AU u vë në dispozicion studentëve një pjesë të teksteve për realizimin e programit mësimor, përveç atyre që mund t'i blejnë në librarinë e shkollës.

Në funksion të këtij qëllimi vepron dhe shtëpia botuese e vetë institucionit, "Albanian University Press" (*Evidenca 1.4, neni 12*). Referuar f. 34 të RVB, biblioteka vë në dispozicion të studentëve botime të ndryshme periodike, në ndihmë të fushës së studimeve. AU boton revistën periodike "Optime", një herë në 6 muaj: <https://albanianuniversity.edu.al/sq/revista-optime/>. Punimet e përfshirë në të, trajtojnë tematika shumëplanëshe.

Literatura e gjendur në bibliotekë garanton pjesërisht përbushjen e objektivave të programit për studentët, gjithsej 174 tekste (*Evidenca 3.8 "Raporti vjetor DSHJ"*). ***GVJ rekomandon shtimin e teksteve (studime të thelluara) që i vlejné programit të studimit sipas drejtimeve përkatës, sidomos literaturë në gjuhë të huaj.***

Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.

Sipas RVB, f. 44, institucioni ka siguruar për studentët akses pa pagesë në bibliotekën online "Questia". Akses është siguruar dhe në faqet online "Elsevier", "Getty", "ERIC", "Cambridge Journals" (*Evidenca "Tabelat përmbledhëse" tabela 17*), nga të cilat, kohëzgjatja e kontratës për bibliotekën online "Questia" ka qenë e vlefshme deri në muajin Dhjetor 2020.

GVJ kërkoi aksesimin në bibliotekën online "Questia" gjatë vizitës në institucion dhe sipas shpjegimeve të stafit administrativ të bibliotekës, aksesimi nuk mundësohej për shkak të përfundimit të kontratës, por po punohet për lidhjen e një marrëveshjeje të re me një tjetër bibliotekë online (*Evidenca shtesë "Minutat e takimit"*). Nuk rezulton nga dokumentacioni të ketë abonim për vitin 2021.

GVJ rekomandon abonimin në një bibliotekë elektronike, të specializuar në fushën e së drejtës, e cila do të përmbushte më mirë plotësimin e qëllimeve të programeve të studimit që ofrohen nga departamenti i shkencave juridike të AU.

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.

Nga dokumentacioni rezulton që biblioteka është e pajisur me pajisjet e duhura teknike si dhe programet kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin e saj nga studentët (RVB, f. 44).

Studentët e regjistruar në të, kanë kartelën e regjistrimit, ku pas regjistrimit mund të shfrytëzojnë në këtë ambient literaturën (*Evidenca shtesë 9 "Kartela e bibliotekës së studentit"*).

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka kishte hapësirën e nevojshme për të mundësuar qëndrimin dhe studimin

	në ambientin e saj, pajisjet teknike dhe tavolinat e punës si dhe programet kompjuterike të nevojshme (<i>Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Biblioteka pasurohet në fillim të çdo viti, sipas një procedure të hartuar për këtë qëllim. Procedura e ndjekur nënkupton që përgjegjësit e departamenteve përpilojnë listat me titujt që duhen përfshirë në bibliotekë, në vijim të kërkesave të pedagogëve, të cilat më pas i dorëzohen administratës së institucionit për t'i siguruar. Blerja e teksteve është e faktuar me faturat përkatëse (<i>Evidenca 3.8 "Raport vjetor DSHJ", f. 27; Evidenca 4.1 "Pasurimi i bibliotekës"</i>). Nga dokumentacioni dhe vizita e zhvilluar në institucion rezultoi që departamenti i shkencave juridike është përpjekur të sigurojë disa tituj që i përshtaten këtij programi të studimeve, tituj dhe tekste gjithsesi të pamjaftueshëm (<i>Evidenca 3.7 "Listat e titujve në DSHJ"</i>). <i>GVJ rekomandon shtimin e literaturës së fokusuar në fushat e së drejtës që përmban ky program studimi, me qëllim që të ndihmohen studentët për të thelluar dijet në to.</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Oraret e punës së bibliotekës në AU janë të disponueshme për studentët nga dita e hënë deri ditën e premte, ora 08.00 – 16.00, si dhe ditën e shtunë ora 08.00 – 12.00. Orari është i shpallur në mjediset e institucionit, në hyrje të bibliotekës si dhe në faqen online të universitetit https://albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka/ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në përputhje me rregullimet e brendshme, në institucion janë ngritur dhe funksionojnë njësitë ndihmëse si kryesekretaria e fakultetit dhe sekretaria mësimore, të cilat menaxhojnë dhe administrojnë informacionin që lidhet me studentët. Shkëmbimi i të dhënave mund të bëhen mes këtyre njërive dhe njërive të tjera ndihmëse apo të shërbimit (<i>Evidenca 1.4 "Statuti i AU", nenet 11-13; Evidenca 1.2 "Rregullore e përgjithshme e AU", nenet 28-29</i>). Informacioni për studentët administrohet në sistemin e të dhënave të sekretarisë mësimore si dhe në regjistrin themeltar të notave (<i>Evidenca 1.2, nenet 28-29</i>). Në sekretari janë arkivuar dosjet e

	<p>secilit student të regjistruar, të çregjistruar apo që ka përfunduar studimet, gjë që u verifikua gjatë vizitës në këtë zyrë nga GVJ (Evidenca shtesë "Minutat e takimit").</p> <p>Institucioni disponon gjithashtu të dhëna për studentët nga momenti i regjistrimit deri në dalje nga ky program studimi (Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabela 21; Evidenca "Mendimi i dekanit").</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Strukturat përkatëse që administrojnë të dhënat lidhur me personelin e punësuar në të, janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 80/2015 dhe aktet e brendshme të AU.</p> <p>Të dhënat që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore, e cila ka vënë në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme (Evidenca 4.2; Evidenca 4.3; Evidenca 4.4). Nga dokumentet e administruar në dosje u vu re që ishin në përputhje me llojet e dokumenteve të përcaktuar në aktet e brendshme rregulluese (Evidenca shtesë "Minutat e takimit").</p> <p>Departamenti i Shkencave Juridike administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre (Evidenca 3.8 "Raporti vjetor DSHJ").</p> <p>Po ashtu, departamenti në fjalë dhe institucioni, zotërojnë të dhëna mbi partnerët e angazhuar në realizimin e programit të studimit (Evidenca 3.8 "Raporti vjetor DSHJ", pika 7; Evidenca 1.6 "Marrëveshje bashkëpunimi").</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas të dhënave që rezultojnë nga dokumentacioni dhe vizita në institucion, strukturat përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në Shkenca Juridike, sekretaria mësimore dhe departamenti, mundësojnë dhënien e informacioneve e dokumentacionit të kërkuar si për personelin, ashtu dhe për studentët. Kjo gjë është mundësuar edhe gjatë periudhës së pandemisë, të shkaktuar nga Covid-19.</p> <p>Informacioni sigurohet dhe përmes sekretarisë online, për personat që disponojnë llogarinë përkatëse në faqen zyrtare të universitetit: http://on.albanianuniversity.edu.al/login.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga të dhënat e siguruar rezultojnë se institucioni ka krijuar mundësinë e komunikimit mes stafit akademik dhe studentëve përgjatë gjithë vitit akademik, nëpërmjet platformave dhe moduleve të dedikuara si "Microsoft Teams", etj. (Evidencat "Tabelat përmbledhëse", tabela 17).</p> <p>Komunikimi realizohet në mënyrë verbale, me anë të postës elektronike, platformave të dedikuara, telefonit, etj., gjë që u</p>



	konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion në takimet me personelin dhe studentët (<i>Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>).			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Rregullimi i brendshëm i veprimtarisë së AU, nëpërmjet statutit dhe rregulloreve, është bërë në mënyrë të tillë që strukturat drejtuese dhe titullarët të marrin dijeni për veprimtaritë e kryera nga personeli akademik dhe ai administrativ (<i>Evidenca 1.2 "Rregullore e përgjithshme; Evidenca 1.4 "Statuti"; Evidenca 3.8 "Raporti vjetor DSHJ"</i>).			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Institucioni mundëson akses në dhënien e informacionit në faqen zyrtare online të veprimtarisë së tij, https://albanianuniversity.edu.al , si në lidhje me objektivat, stafin akademik, studentët, veprimtaritë shkencore, etj. Në përputhje me standardet e vendosur në shtojcën Nr. 5 të VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë", informacioni sigurohet në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze si dhe pjesërisht në një gjuhë të BE, atë italiane.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, AU është pjesë e "UFO" sh.p.k., e cila është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare. Në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, institucioni harton në mënyrë periodike pasqyrat financiare të të ardhurave si dhe të ndarjes së burimeve financiare. AU gëzon autonomi financiare dhe në bazë të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015, harton planin buxhetor afatmesëm, pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit, i cili përditësohet çdo vit (<i>Evidenca 1.4 "Statuti", neni 70</i>). Nga të dhënat (<i>RVB, f. 47</i>), procesi i hartimit të programit financiar nis në muajin Shtator dhe miratohet nga organet kompetente brenda muajit Dhjetor të vitit paraardhës financiar. Para fillimit të vitit të ri akademik, Bordi i Administrimit përcakton kriteret mbi të cilët do të hartohet projektbuxheti vjetor dhe rregullat për mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave që siguron institucioni, të cilat më pas ua përcjell organeve drejtuese akademike dhe administrative. Mbi këto kritere, Administratori i Përgjithshëm i AU, bashkë me zyrën e financës dhe administratorët e njësive kryesore, harton projektbuxhetin vjetor dhe atë afatmesëm, pasur

	<p>parasysh nevojat e paraqitura nga njësitë bazë dhe ato kryesore (<i>Evidenca 1.4 "Statuti i AU", neni 22 në lidhje me nenet 31 e 32 të tij</i>).</p> <p>Burim i të ardhurave sipas statutit janë të ardhurat nga: financimi i ortakut të vetëm, tarifat e paguara nga studentët, kryerja e punimeve kërkimore të porositura dhe shërbimet e tjera të specializuara, dhënia e aktiveve, financimet e pakthyeshme nga burime të huaja në kuadrin e projekteve dy apo shumëpalëshe, dhuratat, grantet dhe donacionet publike, financime të tjerë të ligjshëm (<i>Evidenca 1.4 "Statuti", neni 72</i>).</p> <p>Referuar të dhënave të sjella nga institucioni, të ardhurat faktike janë siguruar vetëm nga tarifat e shkollimit (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse, tabela 18</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, RVB dhe aktet shoqëruese, rezulton se në buxhetin afat-mesëm dhe atë të vitit fiskal të AU, parashikohet edhe mënyra e përdorimit të fondeve, të cilët ndahen në tre kategori:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shpenzime për mësimdhënie dhe shkencë; 2) Shpenzime të administrimit institucional dhe 3) Shpenzime të përgjithshme operative. <p>Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, duke marrë në konsideratë fondin e pagave, kontributet shoqërore dhe shëndetësore, për veprimtari shkencore dhe fondin e ekselencës. Gjatë hartimit të planit mbahen parasysh gjithashtu kërkesat për sigurimin e cilësisë, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, shpenzimet për pasurimin e bibliotekës, bibliotekën online, etj. (<i>F. 47 e RVB</i>). Po ashtu, plani i financimit pasqyron grantet e huaja të përfituara dhe kontratat e lidhura, në përputhje me plotësimin e objektivave që janë vendosur për realizimin e programit të studimit Master Shkencor në Shkenca Juridike (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor DSHJ", pika 5</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Veprimtaria e AU i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm, i cili kryhet nga ekspertë të licencuar. Përveç auditimit të jashtëm, realizohet dhe auditimi i brendshëm (Zyra e Auditit të Brendshëm), nga i cili dalin të dhënat në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë në përputhje me rregullat dhe standardet (<i>Evidenca 1.4 "Statuti i AU" nenet 80-81</i>).</p> <p>Në f. 48 të RVB është pasqyruar se raporti i auditit përmban në mënyrë të detajuar situatën financiare si dhe të dhëna për përdorimin e buxhetit të planifikuar për realizimin e programit mësimor. Të dhënat përfshijnë gjithashtu pagat, shpenzimet operative, detyrimet ndaj të tretëve, etj. Informacionet e përpunuara i kalojnë më pas Bordit të Administrimit, i cili merr masat e nevojshme në vijim lidhur me financimin (<i>Evidenca 1.4 "Statuti", neni 22</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare</p>	<p>Nga aktet rezulton se raportet financiare janë të administruara për tri vitet e fundit akademike. Procedurat përkatëse sipas RVB (f. 48) nisin në</p>

për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	periudhën Mars-Maj, mandej rektorati përgatit raportin financiar, bazuar në planifikimet e kryera në programin financiar. Raporti shqyrtohet dhe miratohet nga Bordi i Administrimit dhe në përfundim të këtij procesi bëhet dhe analiza që planifikon ndërhyrjet e duhura në të ardhmen për mbarëvajtjen e programeve të studimit (<i>Evidenca 1.4 "Statuti", neni 22</i>).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Vlerësohet, nga dokumentacioni i shqyrtuar, se institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit Master Shkencor në Shkenca Juridike. Situata financiare paraqet qëndrueshmëri dhe për ata studentë që do të zgjedhin të ndjekin programet e studimit të ofruar nga Departamenti i Shkencave Juridike. Në këtë pikë, duke mbajtur në vëmendje burimet e të ardhurave faktike, <i>vlerësohet shumti dhe i faktorëve të tjerë në të ardhurat institucionale, sipas parashikimeve të vetë statutit të AU, për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së IAL përballë situatave të paparashikuara të riskut.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>AU ka hartuar procedura të hollësishme për regjistrimin e studentëve, periudhën e studimeve dhe diplomimin e tyre, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion e përkatësisht akteve të brendshëm (<i>Evidenca 1.4 "Statuti", kreu V; Evidenca 1.2 "Rregullore e përgjithshme e AU", kërret IV dhe V; Evidenca 1.5 "Rregullore MSH Shkenca Juridike", kërret III dhe IV</i>).</p> <p>Aktet e brendshme janë hartuar në respektim të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Mbi bazën e akteve themelore të organizimit të brendshëm, institucioni ka ngritur disa zyra dhe zbaton procedura që mbulojnë momentin e regjistrimit, pranimit, transferimit, lënies së studimeve, këshillimit gjatë periudhës së studimeve, diplomimin e studentëve (<i>Evidenca 2.3 "Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve"; Evidencat 3.13.a; 3.13.b dhe 3.13.c; Evidenca 5.1 "Rregullore e zyrës së koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve"; Evidenca 5.2 "Rregullore e zyrës së karrierës dhe alumnit"; Evidenca 5.3 "Udhëzues për zhvillimin e karrierës"; Evidenca 5.4 "Manuali i studentit" Evidenca 5.5 "Komisioni i transferimeve në departament"; Evidenca 2.4 "Manual për punimin e temës"</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>AU ka parashikuar politika dhe procedura regjistrimi, pranimi dhe transferimi të studentëve në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor të aplikueshëm. Procedurat e hyrjes dhe të daljes si dhe ato gjatë kohëvazhimit të studimeve garantojnë respektimin e të drejtave të secilit kandidat/student (<i>Evidenca 1.4 "Statuti", neni 2; Evidenca 1.2 "Rregullore e përgjithshme", neni 3; Evidenca 1.5 "Rregullore MSH Shkenca Juridike", neni 2</i>). Këto parime përmenden dhe në planin strategjik të departamentit të Shkencave Juridike (<i>Evidenca 1.3 "Plani strategjik DSHJ", f. 3-4</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat mbi pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve janë parashikuar në aktet e brendshme të institucionit mbi bazën e kriterëve ligjore të ligjit Nr. 80/2015. Procedura të hollësishme janë parashikuar në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve (<i>Evidenca 2.3</i>).</p> <p>Lidhur me procedurat e tjera gjatë kohëvazhimit të studimeve, përfshi transferimet, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm (<i>Evidenca 2.3 "Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve"; Evidencat 3.13.a; 3.13.b dhe 3.13.c; Evidenca 5.1 "Rregullore e zyrës së koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve"; Evidenca 5.2 "Rregullore e zyrës së karrierës dhe alumnit"; Evidenca</i></p>

	<p>5.3 "Udhëzues për zhvillimin e karrierës"; Evidenca 5.4 "Manuali i studentit"; Evidenca 5.5 "Komisioni i transferimeve në departament"; Evidenca 2.4 "Manual për punimin e temës").</p> <p>Të dhëna të hollësishme studentëve iu sigurohen dhe përmes Manualit të studentit (Evidenca 5.4), i cili mund të konsultohet gjithashtu edhe në faqen elektronike të institucionit.</p> <p>Informacioni i gjendur në këta dokumente përfshin të dhënat e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Neni 56 i Statutit parashikon mundësinë e vendosjes së kritereve shtesë për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët shpallen dhe vihen në dispozicion të QSHA dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (Evidenca 1.4).</p> <p>Sipas nenit 6 të Rregullores së regjistrimeve dhe transferimeve, për programin e ciklit të dytë të studimeve është vendosur si kriter pranimi njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të BE (Evidenca 2.3; Evidenca 1.5, neni 10).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kritereve të përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, f. 50, informacionet lidhur me kërkesat e kritereve për t'u regjistruar në këtë program studimi bëhen të mundur nëpërmjet Zyrës së Regjistrimit dhe Transferimit të studentëve, e cila shpërndan broshura që përmbajnë të dhënat e nevojshme.</p> <p>Informacionet lidhur me kërkesat e regjistrimit janë publikuar dhe në faqen zyrtare të institucionit: https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit-2/.</p> <p>Pranimi i studentëve që ndjekin programin Master Shkencor në Shkenca Juridike është realizuar sipas kritereve që vendos ligji Nr. 80/2015 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i AU, Rregullorja e përgjithshme dhe Rregullorja e programit (Evidenca 1.4; Evidenca 1.2; Evidenca 1.5).</p> <p>Në përputhje me nenin 10 të Rregullores së programit, çdo kandidat duhet të plotësojë këto kushte për të ndjekur programin Master Shkencor në Shkenca Juridike:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ketë një diplomë të nivelit Bachelor me kohëzgjatje minimumi 3 vjet; 2. Të plotësojë kritereve akademike të vendosur nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë; 3. Të paguajë tarifën e caktuar vjetore; 4. Të njohë një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian sipas legjislacionit në fuqi. <p>Neni 10 i Rregullores së programit përcakton dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim dhe procedurën që duhet ndjekur (Evidenca 1.5).</p> <p>Procedurat e detajuara gjenden në Rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve. Pranimet e studentëve kryhen në përputhje me standardet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukurore dhe kritereve e</p>



	pranimit të vendosura nga njësitë bazë dhe njësitë kryesore (<i>Evidenca 2.3, nenet 6, 9, 12, 14, 16</i>). GVJ realizoi vizitën e planifikuar në zyrën e sekretarisë mësimore, ku nga kontrolli i kryer në dosjet e regjistrimit të studentëve, të përzgjedhura në mënyrë rastësore, u konstatua se në to gjendeshin të administruar të gjithë dokumentet e nevojshëm, të përcaktuar në aktet e brendshëm të institucionit, përkatësisht në Rregulloren e programit dhe Rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve. Nuk u konstatuan probleme sa i përket matrikullimit të studentëve (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një nivel akademik në tjetrin.	<p>Në vijim të të dhënave të marra nga vizita në institucion dhe të shqyrtimit të dokumentacionit, rezulton se studentët marrin të dhëna të detajuara mbi programin e studimeve, afatin e përfundimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, akreditimin e programit (<i>Evidenca 1.5, neni 31</i>). Informacioni për këtë program studimi gjendet dhe në faqjen online të AU.</p> <p>Universiteti organizon në javën e parë të vitit akademik një javë orientuese, ku marrin pjesë studentët, personeli akademik dhe ndihmës akademik, me qëllim informimin e studentëve mbi objektivat e programit të studimit, arritjet në fund të tij dhe kriteret për kalimin në vitin pasardhës akademik. Informacioni iu jepet nga departamenti i Shkencave Juridike dhe sekretaria mësimore duke u përqendruar kryesisht në kalendarin e vitit akademik, kurrikulën mësimore, orarin e semestrit të parë, stafin akademik të angazhuar në këtë semestër. Takimet vijojnë dhe gjatë semestrit pasardhës (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor DSHJ", f. 16-17</i>).</p> <p>Të dhëna mbi lëndën dhe syllabus-in e saj, mënyrën e kontrollit të njohurive dhe detyrimet, studentët i marrin në orën e parë të zhvillimit të lëndës nga pedagogu përkatës. Vlerësimet e lëndëve të programit iu bëhen të ditur studentëve nga sekretaria mësimore nëpërmjet adresave elektronike ose drejtpërdrejt (<i>Evidenca 3.8, f. 16-17</i>).</p> <p>Të dhëna të tjera sipas këtij kriteri, studentëve iu sigurohen edhe nëpërmjet Manualit të studentit (<i>Evidenca 5.4</i>).</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni njih mundësinë e transferimit të studentëve në vite ndërmjetëse brenda të njëjtit cikël, në programe të njëjta ose të ngjashme studimi, brenda të njëjtit institucion ose në IAL të tjera, vendase apo të huaja si dhe transferimin në IAL të tjerë (<i>Evidenca 1.4 "Statuti i AU", neni 61; Evidenca 1.5 "Rregullore MSH Shkenca Juridike, neni 13; Evidenca 2.3 "Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve", kreu III</i>). Procedura e përcaktuar në Rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve parashikon në mënyrë të qartë njohjen e studimeve të kryer më parë nga studenti. Me qëllim njohjen e këtyre studimeve të mëparshme, në fillim të vitit akademik departamenti ngre Komisionin e Ekuivalentimit dhe Transferimeve (<i>Evidenca 5.5 "Komisioni i transferimeve në departament"</i>).</p> <p>Informacioni mund të merret në strukturat administrative dhe në nivel departamenti, sikundër edhe përmes Manualit të studentit (<i>Evidenca 5.4</i>).</p> <p>Të interesuarit mund të njihen me kriteret e nevojshëm për transferim edhe nëpërmjet faqes zyrtare të AU: https://albanianuniversity.edu.al/sq/rregullore-e-regjistrimeve-dhe-transferimeve/.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka një strukturë të informimit dhe këshillimit për studentët, të cilët informohen në mënyrë të detajuar mbi programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit, kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të tyre. Njësitë bazë që janë përgjegjës për këtë program studimi, japin informacionin e nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin dhe ndjekjen e programit, syllabus-et, praktikat, ushtrimet, laboratorët, etj. (<i>Evidenca Nr. 1.5, neni 31</i>).</p> <p>Ky informacion iu sigurohet në orën e parë të zhvillimit të lëndës nga departamenti si dhe pedagogu përkatës (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor", f. 17</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Orientimi i studentëve sa i përket diplomimit, realizohet nga departamenti, i cili iu siguron informacionin e nevojshëm. Studentëve iu jepen të dhënat e nevojshme që në fillim të vitit akademik rreth procedurave të vlerësimit dhe mbylljes së studimeve, përfshi procesin e diplomimit (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor", f. 17</i>).</p> <p>Zyra e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve ka hartuar një manual për punimin e temës, i cili lehtëson punën e studentëve që mbyllin studimet përmes punimit të saj (<i>Evidenca 2.4</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka publikuar udhëzues të posaçëm siç është Manuali i studentit (<i>Evidenca 5.4</i>), i cili gjendet dhe online https://albanianuniversity.edu.al/sq/manuali-i-studenteve.</p> <p>Po ashtu, nëpërmjet Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve dhe Departamentit të Shkencave Juridike, institucioni</p>

	organizon takime të hapura për të informuar të interesuarit dhe studentët mbi programin e studimit (<i>Evidenca 5.1, nenet 2, 3, 10</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve që do të ndjekin, si nga stafi akademik, ashtu dhe ai administrativ i AU. Në plotësim të këtij kriteri, IAL organizon javën e orientimit të studentëve që përkon me javën e parë mësimore të vitit akademik, ku studentët marrin informacione të detajuara mbi programin e studimit (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor"</i>).</p> <p>Në fillim të secilit vit akademik, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve përgatit dhe shpërndan informacion të dedikuar për studentët e vitit të parë, duke përfshirë në mënyrë jo shteruese: një ekstrakt nga rregullorja e fakultetit, veprimtaritë e strukturave akademike dhe administrative në institucion, veprimtaritë e njësive ndihmëse dhe të shërbimit për studentin, Kodin e Etikës (<i>Evidenca 5.1, neni 10</i>).</p> <p>Rol të rëndësishëm në informimin e studentëve luajnë dhe manualet që gjenden në faqen zyrtare elektronike të IAL: https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/studenti/manuale-dhe-udhezime/.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Departamenti i Shkencave Juridike dhe pedagogët e secilës lëndë, në koordinim me sekretarinë mësimore, sigurojnë dhënien e informacioneve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për modulet, lëndët, ngarkesën mësimore, orët në auditor, syllabus-et e detajuar, praktikat, ushtrimet, detyrat e kursit si dhe çdo veprimtari tjetër që përfshihet në programin e studimit (<i>Evidenca 1.5, neni 31</i>).</p> <p>Informimi mundësohet në periudha të ndryshme të vitit akademik (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor" f. 17</i>).</p> <p>Të dhëna të hollësishme dhe informacionet e nevojshme gjenden dhe në manualin e studentit (<i>Evidenca 5.4</i>) dhe në manuale të tjerë, të cilët mund të aksesohen online në faqen zyrtare elektronike të AU: https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/studenti/manuale-dhe-udhezime/.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Sipas nenit 32 të Rregullores së programit të studimit, institucioni vë në dispozicion të studentëve të gjithë mjetet e nevojshme për të mundësuar ecurinë e tyre nga regjistrimi deri në punësim (<i>Evidenca 1.5</i>).</p> <p>Në përputhje me këtë rregullim dhe aktet e tjerë të brendshëm, AU ka ngritur Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, nëpërmjet së cilës këtyre të fundit iu ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. Studentët ndihmohen të kuptojnë aftësitë e tyre dhe orientohen përmes leksioneve të hapura, takimeve, debateve, vizitave, internship-eve, etj., për punësim pas përfundimit të studimeve (<i>Evidenca 5.1 "Rregullore e zyrës së koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve"</i>).</p> <p>Me rëndësi në këtë drejtim është dhe hartimi i një dokumenti të posaçëm për studentët lidhur me orientimin për në tregun e punës (<i>Evidenca 5.3 "Udhëzues për zhvillimin e karrierës"</i>).</p> <p>Nëpërmjet Zyrës së karrierës dhe alumni-t, institucioni siguron të dhëna për studentët, për fazën pas diplomimit të tyre lidhur me mundësitë për zënie me punë. Kjo zyrë siguron lidhjet e nevojshme mes alumni-t, studentëve në ndjekje të studimeve dhe botën e punës, gjithashtu mbështet të diplomuarit në planet e tyre për karrierë dhe përshtatjen me tregun e punës (<i>Evidenca 5.2 "Rregullore e zyrës së karrierës dhe alumni-t"</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike dhe të gjitha strukturat mbështetëse të IAL mundësojnë që studentët të marrin në vëmendje të dhënat e nevojshme mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e tjerë që i vlejné programit të studimit. Informacioni jepet i përditësuar, sipas rregulimeve të bërë nga institucioni (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor", f. 16-17</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga vizita e kryer në institucion e nga takimi me studentët, rezulton se strukturat përgjegjëse në rang akademik dhe administrativ kanë mundësuar dhënie e informacionit në mënyrë të saktë e të kuptueshme. Ky informacion është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë (sidomos gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19), duke realizuar shkëmbimin e të dhënave në rrugë elektronike (nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit: https://albanianuniversity.edu.al/sq/?s=platforma+online, postës elektronike, etj.) (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor"</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve.</p>	<p>Sipas neneve 28 e 29 të Rregullores së përgjithshme të AU, sekretaria mësimore është përgjegjëse, ndër të tjera, për të ruajtur informacionin, dokumentacionin dhe dokumentet që ilustrjnë aktivitetin mësimor të studentëve (<i>Evidenca 1.2</i>).</p> <p>Zyra e sekretarisë mësimore administron dosjet personale të studentëve, të dhënat që lidhen me provimet përfundimtare dhe notat përfundimtare të vlerësimit të tyre. Këto të dhëna të administruara u konsultuan gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ, si dosje të studentëve, ashtu dhe</p>

	procesverbale të vlerësimit të tyre, dokumente të cilët u gjetën të rregullt në formë dhe përmbajtje (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve për programin e studimit për secilin vit akademik objekt shqyrtimi. Të dhënat përfshijnë statistikat e përgjithshme mbi numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat mesatare në hyrje, aktivitetet ku janë përfshirë, studentët e diplomuar dhe të dhënat mbi punësimin e tyre (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabelat 21, 22, 23; Evidenca 3.8, f. 23-24; Evidenca "Mendimi i dekanit"</i>).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Institucioni disponon të dhënat e nevojshme statistikore për numrin e studentëve të regjistruar, të çregjistruar apo me studime të papërfunduara, për programin e studimeve të ciklit të dytë. Të dhënat administrohen nga sekretaria mësimore, në regjistra dhe dokumentacionin e mbajtur posaçërisht për këtë qëllim (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabela 21; Evidenca "Mendimi i dekanit"; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni ka mbajtur të dhënat e nevojshme që tregojnë ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve, nga regjistrimi deri në diplomim, fakt i cili vërtetohet nga dokumentacioni (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabelat 21 dhe 23; Evidenca 3.8 "Raporti vjetor", f. 22-24</i>), sikundër dhe nga dokumentet e depozituar në sekretarinë mësimore si regjistra, procesverbale të notave, etj. (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga aktet e konsultuar si dhe nga vizita në institucion, konstatohet që të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga strukturat e ngritura për këtë qëllim, janë mbajtur në mënyrë të saktë dhe mund të aksesohen me lehtësi, në përputhje me rregulloren për sekretarinë mësimore, e cila është publikuar në faqen zyrtare të institucionit: https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Rregullore-sekretarise-e-ndryshuar.pdf .
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje	Institucioni e plotëson këtë kriter nëpërmjet bashkëpunimit të vendosur mes strukturave përgjegjëse, të tilla si sekretaria mësimore, e cila në

të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni-t dhe me departamentin e Shkencave Juridike, janë të përfshirë në procesin e krijimit të raporteve analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe të shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre. Të dhënat e hartuara dhe të përpunuara shërbejnë si bazë për marrjen e masave të nevojshme me qëllim përmirësimin e këtyre treguesve (Evidenca 1.3 “Plani strategjik DSHJ”; Evidenca 3.8 “Raporti vjetor”; Evidencat shtesë 8; 8.a; 8.b; 8.c).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në përputhje me nenin 98/1, gërma c, të ligjit Nr. 80/2015, studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë. Në përputhje me këtë parashikim ligjor, në nenin 47, pika 1, në lidhje me nenet 19/6, gërma b, 25/3 të statutit të AU, përcaktohet se studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e AU dhe përfaqësohen në Këshillin Studentor, Senat dhe në Komisionet për Kurrikulat dhe Mësimin, për Vlerësimin Institucional, dhe atë për Kërkimin Shkencor dhe Botimin (Evidenca 1.4 “Statuti”). Të njëjtat parashikime gjenden dhe në Rregulloren e përgjithshme të institucionit (Evidenca 1.2, neni 57).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Rezulton nga aktet e vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion që, në pikëpamje formale, e drejta për pjesëmarrje e studentëve në vendimmarrjen e AU është garantuar në mënyrë efektive. Emrat e studentëve, anëtarë të senatit, etj., mund të konsultohen lehtësisht në faqen zyrtare elektronike të institucionit (https://albanianuniversity.edu.al/sq/senati-akademik/) si dhe në dokumentacion (Evidenca 3.3 “Grupi i cilësisë në departament”; Evidenca 6.2 “Ngritja e KVI”; Evidenca 6.6 “Rregullore për mbarëvajtjen e kurrikulave”). Gjithsesi, nuk bëhet dallimi nëse bëhet fjalë për studentë të programeve të ciklit të parë apo të dytë të studimeve, përfaqësues në këto struktura. Mendimet e studentëve mblidhen në mënyrë periodike dhe shqyrtohen nga institucioni me qëllim marrjen e masave për ndërmarrjen e veprimeve në të ardhmen (Evidenca 3.8 “Raporti vjetor DSHJ” f. 12-15).

Abdullah

AS

	Një prej studentëve është dhe anëtar i GVB, por që nuk përcaktohet nëse i përket këtij programi studimi (<i>Anëtarët e grupit të punës së RVB</i>).			
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.	Në lidhje me këtë kriter, konstatohet që është mbajtur parasysh ngarkesa e detyrimeve akademike të studentëve, duke pasur në vëmendje shtrirjen e viteve akademike, numrin e lëndëve, etj. Procedurat e parashikuara janë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe synojnë të pakësojnë sa më shumë qasjen burokratike (<i>Evidenca 1.5 "Rregullore MSH Shkenca Juridike"</i>). Njohja e studimeve të plota ose të pjesëshme të mëparshme rezultojnë e rregulluar nga aktet e brendshme si dhe strukturat e ngritura për këtë qëllim (<i>Evidenca 2.3 "Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve"</i> ; <i>Evidenca 5.5 "Komisioni i transferimeve në departament"</i>).			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Nëpërmjet rregullimeve të bërë në aktet e brendshëm, AU ka garantuar përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, përkatësisht në statut dhe në rregulloren e përgjithshme. Nga pikëpamja e realizimit të kriterit, studentëve u jepet mundësia të shprehen mbi elementet e programit të studimit (<i>Evidenca 3.1 "Pyetësori"</i> ; <i>Evidenca 3.2 "Shkresë fokus-grupet"</i>), mendime të cilët merren në shqyrtim nga strukturat përgjegjëse të institucionit, që shpie në rishikim apo përmirësim të këtyre elementeve (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor" f. 10-15</i> ; <i>Evidenca 6.6 "Rregullore për mbarëvajtjen e kurrikulave" neni 8</i> ; <i>Evidenca 6.7 "Model raporti vetëvlerësimi programi"</i> ; <i>Evidenca R.2. "Raporti i vetëvlerësimit të programit të studimit"</i>). Përfshirja në këtë proces garantohej gjithashtu nga Këshilli Studentor, veprimtaria e të cilit iu bëhet e njohur studentëve dhe online: https://albanianuniversity.edu.al/sq/keshilli-studentor .			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës	Nenet 18-24 të Rregullores së programit të studimit normojnë në mënyrë të detajuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve të studentit nga pedagogu i lëndës, përfshi dhe procedurën e ankimimit (<i>Evidenca 1.5</i>). Me këto rregulla studenti njihet dhe përmes manualit të studentit (<i>Evidenca 5.4</i>), i cili është publikuar online. Nga dokumentacioni (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor" apo dhe RVB</i>), si dhe nga vizita në institucion, nuk rezultojnë që të ketë pasur ndonjë proces të ezauruar në të gjitha shkallët përkatëse lidhur me procesin e vlerësimit të dijeve, pasi çdo pretendim i studentëve që kanë pasur të tillë, është sqaruar nga pedagogu i lëndës (<i>Evidenca shitesë "Minutat e takimit", takimet me stafin akademik, studentët dhe vizita në sekretarinë mësimore</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni është i angazhuar në fushën e kërkimit shkencor dhe në nxitjen e personelit akademik që të përfshihet në këtë veprimtari (<i>Evidenca 1.4, neni 5, 9, 68-69</i>). Për këtë qëllim, rezulton nga takimi me stafin akademik, që anëtarët e tij kanë qenë pjesëmarrës në disa veprimtari, si konferenca ndërkombëtare apo veprimtari kërkimore-shkencore (<i>Shembull: Evidenca shitesë 2</i>). Në këtë drejtim, universiteti nxit dhe mbështet botimet e punimeve në revista të ndryshme shkencore, në përputhje me fondin për kërkimin shkencor të IAL, ku kriteret dhe procedurat për marrjen e mbështetjes financiare janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit: https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-dhe-procedurat-qe-njesite-kryesore-njesite-baze-dhe-kerkuesit-shkencor-si-individe-duhet-te-ndjekin-per-te-perfituar-mbeshtetjen-financiare-per-kerkimin-shkencor/.</p> <p>Konstatohet gjithashtu që strukturat kompetente të AU kanë rishikuar përmbajtjen e kontratave të punës të personelit akademik, duke parashikuar në to, të drejtën e stafit me kohë të plotë për të kërkuar: 1) mbështetje financiare nga AU për aktivitete shkencore brenda ose jashtë vendit ose botime shkencore në fushën që përbën prioritet për njësinë përkatëse bazë si dhe, 2) të drejtën e shkëputjes nga angazhimet e institucionit për kryerjen e vitit sabatik një herë në shtatë vjet, me miratimin e njësisë bazë, për periudha kohore deri në një vit, për të punuar për përparimin akademik (<i>Evidenca 4.2: Evidenca 4.3</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Në përputhje mesa ka përcaktuar në statut për fushën e kërkimit shkencor, rezulton që universiteti të jetë angazhuar në bashkëpunim me universitetin e Salerno-s, Itali, në kuadër të projektit EU WEB EU-Western Balkans (Cooperation Justice and Home Affairs) (<i>Evidenca R.4; Evidenca R.5; Evidenca R.6</i>).</p> <p>Marrëveshjet e përbashkëta synojnë në angazhimin në projekte kërkimore-shkencore, të cilat do të siguronin të ardhura shtesë apo do të mundësonin dhe mobilitetin e rritjen profesionale të personelit akademik (<i>Evidenca 3.8, pikat 6-8</i>).</p> <p><i>GVJ konstaton se është e nevojshme që IAL të shtojë përpjekjet në lidhjen e marrëveshjeve të reja, për të intensifikuar veprimtaritë në fushën e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në fushën e kërkimit shkencor është një ndër objektivat e stafit akademik të këtij programi studimi (<i>Evidenca 1.3, objektivi 2</i>).</p> <p>Në përputhje me këtë objektivi, studentëve u mundësohet marrja dijeni për aktivitetet e ndryshme ku mund të prezantohen studime apo punime shkencore (si p.sh. në faqen zyrtare të IAL:</p>

	<p>https://albanianuniversity.edu.al/sq/veprimtaria_kerkimore_shkencore_2017_2019/).</p> <p>Rezulton që studentët të jenë bërë pjesë e punimeve shkencore (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabela 22; Evidenca shtesë 1</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Në përputhje me rregullimet që ka bërë në statut sa i përket fushës së kërkimit shkencor, nga aktet e administruar dhe nga vizita në institucion (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>), konstatohet që universiteti siguron mbështetje për stafin akademik dhe për studentët, në drejtim të publikimit të punimeve të tyre në revista shkencore ndërkombëtare (<i>Evidenca 3.8, pika 5</i>).</p> <p>Sipas shpjegimeve të dhëna gjatë vizitës në institucion, një pjesë e punimeve mund të publikohen në revistën "Optime", pa pagesë (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"; Evidenca 1.3, objektivi Nr. 2</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Synimi i institucionit në përgjithësi dhe i personelit akademik të këtij programi studimi në veçanti, për të nxitur dhe mbështetur studentët drejt studimeve inovative, shprehet në aktet e krijuara, që ilustronjë këtë objektiv (<i>Evidenca 1.4; Evidenca 3.8; Evidenca R.1, pika 2</i>). Nëpërmjet shembullit të tyre dhe krijimit të mundësive për zbatim të marrëveshjeve me IAL të huaja, kërkohet të arrihet të menduarit ndryshe tek studentët e këtij programi, në përputhje me zhvillimet e reja objektive dhe për dhënien e ideve të reja në fushën e së drejtës. Në fakt, disa prej studentëve kanë publikuar punime (<i>Evidenca shtesë 1</i>).</p> <p>Në funksion të përmbushjes së këtij kriteri, studentët kanë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme ekstrakurrikulare, që i motivojnë në zgjerimin e dijeve sipas fushave të studimit që kanë përzgjedhur (<i>Evidenca 3.9</i>).</p> <p>Ndërsa, sa i përket angazhimit në drejtim të patentave, vlerësohet se nuk gjen zbatim për studentët e këtij programi studimi.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës.</p>	<p>Rregullat lidhur me diplomimin e studentëve janë përcaktuar në kreun V të rregullores së programit (<i>Evidenca 1.5</i>).</p> <p>Shtjellimi i rregullave për punimin e diplomës është realizuar në dokumentin specifik të manualit për punimin e saj (<i>Evidenca 2.4</i>).</p> <p>Sikundër raportohet në faqen 56 të RVB, gjatë këtij procesi, studentët mbajnë kontakte të rregullta me personelin akademik, ku sipas nevojave të punimit që është duke u kryer, marrin dhe ndihmën e duhur për secilin nga aspektet që lidhet me punimin e një diplome.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>AU i ka mëshuar politikës së bashkëpunimit me organizmat shkencorë kombëtarë, duke e shprehur fillimisht këtë në statutin e institucionit dhe në dokumente të tjerë të brendshëm strategjikë (<i>Evidenca 1.4, neni 4; Evidenca 1.3, objektivi Nr. 3</i>).</p> <p>Në përputhje me këto përcaktime, brenda institucionit është ngritur dhe funksionon Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë që mundëson vënien në praktikë të politikave të bashkëpunimit (<i>Evidenca 1.4, neni 11</i>).</p> <p>Vërehet nga aktet se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh për arritjen e këtij objekti, me disa universitete vendase e të huaja (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabela 5</i>) si dhe është bërë pjesë e programeve Erasmus, për të siguruar mobilitetin e stafit dhe studentëve (<i>Evidenca R.5; Evidenca R.6</i>).</p> <p>Rezultoni nga të dhënat se 4 studentë të këtij programi kanë përfituar nga mobiliteti, programi Erasmus (<i>Evidenca "Tabelat përmbledhëse", tabela 20; Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Aktet e brendshme të universitetit nxitin stafin akademik në përdorimin e metodave të tilla të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët, në mënyrë që ata të jenë të përgatitur për të ndjekur ciklin e tretë të studimeve (<i>Evidenca 1.5, neni 4</i>).</p> <p>Programet e lëndëve, nga ana tjetër, janë ndërtuar në mënyrë të tillë që garantojnë po ashtu vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve (<i>Evidenca 2.1</i>).</p> <p>Në funksion të kërkimit, në kurrikulën e programit është parashikuar dhe zhvillohet si lëndë më vete ajo e "Kërkimit shkencor" (<i>Evidenca "Metodat e kërkimit shkencor"</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Përpjekjet pozitive të universitetit në drejtim të përfshirjes së studentëve vendas dhe të huaj në projekte kërkimore gjejnë shprehje në pari në aktet e brendshme të IAL (<i>Evidenca 1.3, objektivi strategjik Nr. 2</i>).</p> <p>Në funksion të përmbushjes së këtij kriteri dhe përfshirjen e studiuesve të rinj në projekte kërkimore kombëtare e ndërkombëtare, departamenti ka fituar dhe është pjesë e projekteve Jean Monnet (<i>Evidenca R.6</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Institucioni ka krijuar bazën e nevojshme rregullatore në fushën e kërkimit shkencor, ku mund të përfshihen dhe kërkuesit shkencorë të huaj (<i>Evidenca 1.4, nenet 4, 68; Evidenca 1.2, nenet 3, 17, 18; Evidenca 1.3, objektivi Nr. 2</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Politika favorizuese e universitetit ndaj mobilitetit të studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare shprehet më së miri në aktet e brendshme të tij (<i>Evidenca 1.4; Evidenca 1.2; Evidenca 1.5</i>).</p> <p>Një ndër objektivat e IAL është zgjerimi i rrjetit të bashkëpunimeve me universitete dhe institucione kërkimore, me qëllim që t'u ofrohet studentëve përvojë ndërkombëtare (<i>Evidenca 1.5, objektivi Nr. 3</i>). Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë është ngarkuar me detyrën për të</p>

	<p>mundësuar lëvizjen e studentëve dhe shkëmbimin e studentëve e personelit në përgjithësi (<i>Evidenca 1.1, neni 11</i>). Të dhënat mbi këtë zyrë gjenden dhe në faqen zyrtare të institucionit: https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-marrdhenieve-me-jashte/.</p> <p>Rezulton që AU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitetin e Salerno-s, Itali (<i>Evidenca 3.10</i>). Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, departamenti i Shkencave Juridike në AU ka krijuar bashkëpunim me departamentin e Shkencave Juridike në universitetin e Salerno-s, Itali, në kuadër të projektit “EU-Western Balkans” (Cooperation on Justice and Home Affairs), projekt i cili shërben ndër të tjera për mobilitetin e studentëve. Rezulton nga të dhënat dhe takimet në institucion se deri më tani, nga ky program kanë përfituar 4 studentë (<i>Evidenca “Tabelat përmbledhëse”, tabela 20; Evidenca shitesë “Minutat e takimit”</i>).</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore.</p>	<p>Sipas të dhënave të vëna në dispozicion, në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit me universitetin e Salerno-s, Itali, në program ka qenë e ftuar për të zhvilluar lëndën “E drejta e Bashkimit Evropian e avancuar”, pedagoge Teresa Russo (<i>Evidenca 1.7</i>).</p> <p>Nga ana tjetër, universiteti ndjek politika pozitive në drejtim të kërkimit shkencor, duke parashikuar dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë, proces i cili menaxhohet nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike (<i>Evidenca 1.2, nenet 17 dhe 18</i>). Veprimtaria e kësaj zyre është e publikuar në fazen zyrtare të institucionit: https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/kerkimi-shkencor/.</p> <p><i>Nuk ka të dhëna lidhur me numrin e kërkuesve shkencorë të huaj, si personel ashtu dhe studentë të huaj.</i></p> <p>Gjithsesi, pavarësisht politikave pozitive në fushën e kërkimit shkencor, me qëllim përmbushjen e plotë të këtij kriteri, <i>GVJ rekomandon përcaktimin e saktë të procedurave e ftesës ndaj personelit akademik të huaj dhe studentëve të huaj për pjesëmarrje në veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi V.8 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar procedura e ngritur njësi të posaçme në drejtim të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve, sipas rregulimeve të bërë në statut, rregulloren e përgjithshme si dhe në rregulloren e programit (<i>Evidenca 1.5 "Rregullore MSH Shkenca Juridike", neni 26</i>), me të cilat studenti njihet në mënyrë të përgjithshme në momentin e nënshkrimit të kontratës me IAL (<i>Evidencat 3.13.a; 3.13.b; 3.13.c</i>) si dhe nëpërmjet manualit të studentit (<i>Evidenca 5.4</i>).</p> <p>Informimi dhe shërbimi ndaj studentit realizohet nga sekretaria mësimore, në nivel departamenti si dhe nga zyrat e tjera të ngritura për këtë qëllim, si ajo e regjistrimeve, e koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve, etj. Informacioni i nevojshëm dhe zyrat që realizojnë shërbimet përkatëse janë të publikuara dhe në faqen online të AU: https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/studenti/.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në vijim të konsultimit me dokumentacionin dhe pas bisedës së zhvilluar studentët gjatë vizitës në institucion, rezulton se këta të fundit marrin këshillimin dhe mbështetjen e nevojshme përgjatë kohëvazhdimin të procesit mësimor të programit të studimit. Institucioni ka ngritur një sistem të posaçëm për këtë qëllim, ku rol kryesor luan Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, e cila siguron mbështetjen e nevojshme ndaj studentëve që të orientohen drejt në fushën e studimeve, duke pasur në vëmendje objektivat për të ardhmen (<i>Evidenca 5.1 "Rregullore e zyrës së koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve"</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në funksion të përmbushjes së këtij kriteri, në AU funksionon Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, përmes së cilës studentët marrin informacione dhe këshillim për karrierën (<i>Evidenca 1.5 "Rregullore e programit MSH Shkenca Juridike", neni 32; Evidenca 5.1 "Rregullore e zyrës së koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve"</i>).</p> <p>Departamenti bashkëpunon ngushtësisht me këtë zyrë në funksion të asistimit të studentëve të tij. Zyra zhvillon lidhjet mes studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ, me tregun e punës, nëpërmjet programit të mentorimit. Studentët këshillohen si të aplikojnë për pjesëmarrje në shkolla verore, specializime, vende pune, etj (<i>Evidenca 1.3 "Plani strategjik DSHJ" f. 11</i>).</p> <p>Programi i mentorimit përfshin dhe këshillimin e kryerjen e praktikës profesionale nga studentët, nën mbikëqyrjen e mentorit nga radhët e stafit akademik të departamentit. Institucioni rezulton të ketë lidhur disa marrëveshje me institucione publike e private, ku ata planifikohet të zhvillojnë praktikën profesionale (<i>Evidenca 1.6 "Marrëveshje bashkëpunimi"</i>) në përputhje me nenin 27 të Rregullores së programit. <i>GVJ, në lidhje me këtë kriter, vlerëson të rekomandojë përditësimin e marrëveshjeve (struktura e prokurorisë dhe gjykatës për krime të rënda nuk ekziston më) si dhe lidhjen e marrëveshjeve</i></p>

	<i>dhe me institucione e organe të tjerë, të specializuar sipas fushave të së drejtës, në përputhje me profilizimet e këtij programi studimi.</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	<p>Zyra e alumni-t dhe karrierës siguron të dhëna për studentët, për fazën pas diplomimit të tyre lidhur me mundësitë për zënie me punë (<i>Evidenca 5.2 "Rregullore e zyrës së karrierës dhe alumnit"</i>). Në funksion të veprimtarisë së kësaj zyre është hartuar dhe udhëzuesi për zhvillimin e karrierës (<i>Evidenca 5.3</i>).</p> <p>Zyra mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve që i përkasin këtij programi studimi (<i>Evidencat shitesë 8; 8.a; 8.b; 8.c</i>).</p> <p>Të dhënat administrohen në përputhje me nenin 8 të Rregullores për Zyrën e Karrierës dhe Alumni-t dhe iu vihen në dispozicion organeve drejtuese të IAL (<i>Evidenca 5.2</i>).</p> <p>Informacionet e kësaj zyre janë të aksesueshme dhe nga studentët; gjithashtu të dhëna mbi veprimtarinë e saj gjenden dhe në faqen online të institucionit: https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-karrieres-dhe-alumnit/.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në	Sipas përcaktimeve ligjore të nenit 103 e vijues të ligjit Nr. 80/2015, AU ka bërë parashikime në aktet e brendshme rregullatore lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, përkatësisht në nenet 65-67 të statutit, nenet 13-14 të Rregullores së përgjithshme, nenin 33 të Rregullores së programit (<i>Evidencat 1.4; 1.2 dhe 1.5</i>).

<p>fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në përputhje me këto parashikime, institucioni ka hartuar politikat përkatëse si dhe strukturat e nevojshme, që merren me monitorimin dhe përmirësimin në vijimësi të cilësisë, në nivel institucional. Detyrat e njëjshme lidhen me garantimin e plotësimin të standarteve të cilësisë në procesin akademik nga ana e strukturave dhe organeve të institucionit. Institucioni ka hartuar dhe dokumentin “Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” (Evidenca 6.4).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në vijim të vendimit Nr. 178 Prot., datë 23.07.2010 të senatit, brenda AU është krijuar Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (përmendur në vijim me inicialet ZSBC) (Evidenca 6.1 “Ngritja e ZSBC”). Me vendimin Nr. 4, datë 22.12.2016 të senatit akademik është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Vlerësim Institucional, ku njëri prej anëtarëve caktohet nga studentët (Evidenca 6.2 “Ngritja e KVI”). Grupi i vlerësimit të cilësisë funksionon dhe në nivel departamenti (Evidenca 6.3 “Sigurimi i cilësisë në nivel departamenti”), anëtarët e të cilit përtërihen çdo vit. Rëndësia që i ka dhënë IAL strategjisë nuk shprehet vetëm në mënyrë të përgjithshme në strategjinë institucionale, por politika të detajuara janë shprehur në strategjinë për sigurimin e brendshëm të cilësisë (Evidenca 6.4). Në këtë proces dhe struktura janë përfshirë dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve. Gjithashtu, në këtë proces është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, neni 6 i Rregullores së NJSBC (Evidenca 6.8), një konsulent juridik (Evidenca 6.5.a) dhe një konsulent për përmirësimin dhe zhvillimin e kurrikulave (Evidenca 6.5.b).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni përdor metoda të ndryshme për vlerësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe vlerësimit të brendshëm të institucionit, të cilat janë detajuar në rregulloren e NJSBC (Evidenca 6.8 “Rregullore e NJSBC”). Informacioni që institucioni siguron nga studentët lidhet me aspekte të mësimdhënies, të programeve dhe të lëndëve mësimore. Metodrat që përdoren janë: intervista, fokus grupi, pyetësorë cilësorë; formularë të standardizuar vlerësimi; fokus grupe (Evidenca 6.8). Vlerësimi që kryhet nga stafi akademik lidhet me aspekte të programeve, lëndëve dhe mësimdhënies. Metodrat që përdoren janë: vrojtimi i drejtpërdrejtë në auditor, analiza e përmbajtjes së materialeve, raportet e vlerësimit, etj. (Evidenca 6.8 “Rregullore e NJSBC”). Në mënyrë periodike, institucioni realizon vlerësimin e jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, në vijim të të cilëve merr masat e duhura për plotësimin e rekomandimeve.</p>


<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Në strategjinë e brendshme, AU ka paraqitur politikat e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit (<i>Evidenca 1.1 "Strategjia e zhvillimit institucional" f.17-19</i>), të zbrërthyer në mënyrë të hollësishme dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca 6.4</i>).</p> <p>Vlerësimi kryhet në mënyrë periodike. Në përfundim të vitit akademik, grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti plotëson raportin e vetëvlerësimit të programit të studimit, ku jepen të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshëm të realizuar, planet për ndryshimet dhe përmirësimin në të ardhmen, <i>feedback-u</i> i marrë nga studentët, nga personeli akademik, të dhëna mbi ecurinë e studentëve (<i>Evidenca 6.8 në lidhje me evidencën 6.6</i>).</p> <p>Në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik, departamenti harton raportin vjetor, ku përfshihen të dhëna përshkruese si dhe sasiore mbi programin e studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e studentëve, kalueshmërinë dhe notën mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, të dhënat mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore si dhe masat për t'u ndërmarrë në të ardhmen (<i>Evidenca 3.8 "Raporti vjetor DSHJ"</i>).</p> <p>Në këtë mënyrë, kontrolli mbi cilësinë nis nga niveli bazë e më pas kalon në rang institucional, duke përfshirë të gjithë hallkat e IAL.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në lidhje me programet e studimit të ciklit të dytë, në kuadër të vlerësimit të cilësisë janë ngritur dhe grupet e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti (<i>Evidenca 6.3 "Sigurimi i cilësisë në nivel departamenti"</i>), sikundër ka ndodhur dhe në departamentin e Shkencave Juridike. Në përbërje të këtij grupi janë dy pedagogë të brendshëm të departamentit si dhe një student; pedagogët kanë gradën shkencore "Dr" (<i>Evidenca 3.3 "Grupi i cilësisë në departament"</i>).</p> <p>Grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti bashkëpunon me lektorët përkatës për rishikimin e kurrikulave dhe syllabuse-ve. Në vijim, raporti dërgohet në rrugë shkencore pranë NJSBC dhe në rast propozimi ndryshimesh, bashkëpunohet me zyra të tjera dhe strukturat drejtuese të institucionit (<i>Evidenca 6.8 "Rregullore e NJSBC", neni 7</i>).</p>




<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>NJSBC planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë si për programet e studimit, ashtu dhe për institucionin. Kryerja e procedurave, përmes mekanizmave të përcaktuar nga NJSBC, bëhet në mënyrë periodike mbi programin e studimit. Kur është e nevojshme, rekomandohen masa për ndryshimin, rishikimin ose përmirësimin e elementeve të këtij programi (<i>Evidenca 6.8 "Rregullore e NJSBC"</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në aktet e brendshme për sigurimin e cilësisë, institucioni ka parashikuar shfrytëzimin e një sërë metodologjish vlerësimi, instrumentesh matjeje dhe vlerësimi për programin e studimit. Instrumentet e matjes së cilësisë janë specifikuar në strategjinë përkatëse si dhe në mënyrë të detajuar në rregullore (<i>Evidenca 6.4 "Strategjia për sigurimin e cilësisë"; Evidenca 6.8 "Rregullore e NJSBC"</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në përfundim të procesit të vlerësimit, si në rang departamenti, ashtu dhe institucional, të dhënat e grumbulluara përpunohen dhe dokumentohen në aktet e mbajtur për këtë qëllim, të cilët më pas dërgohen në instancat përgjegjëse për vendimmarrje të mëtejshme (<i>Evidenca shtesë 7.a "Raport vjetor NJSBC"; Evidenca shtesë 7.b "Raport vjetor ZZHK"</i>).</p> <p>Në mënyrë më të detajuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në rastin kur propozohen ndryshime në programin e studimit (kurrikulat), informacioni shkresor dërgohet pranë zyrës së kurrikulave dhe komisionit për kurrikulat dhe mësimin. Nëse vlerësohen ndryshimet e kurrikulave, akti përkatës i dërgohet për miratim senatit. - Në nivel institucional, të dhënat e vlerësimit NJSBC i përpunon dhe i dërgon pranë Komisionit për Vlerësim Institucional, i cili më pas e përcjell në Senat, me qëllim marrjen e vendimeve në funksion të përmirësimeve të nevojshme (<i>Evidenca 6.8 "Rregullore e NJSBC"</i>). <p>Hartimi i raportit dhe procedurat për njohjen me të nga autoritetet përgjegjëse janë shtjelluar në strategjinë për sigurimin e cilësisë (<i>Evidenca 6.4</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Në strategjinë e sigurimit të cilësisë janë përcaktuar saktë elementet që duhet të përmbajë raporti vjetor i vlerësimit. Raporti duhet të përmbajë dhe të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultatet që rrjedhin nga ai. Raporti përmbledh të dhëna të marra nga aktorë të ndryshëm, duhet të përqendrohet në përvojën e studentëve si dhe mënyrën e adresimit të çështjeve gjatë vitit akademik. Strategjia vë theksin në marrjen e vendimeve për miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit (<i>Evidenca 6.4 "Strategjia për sigurimin e cilësisë"</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.3




Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga përmbajtja e dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton që programi i studimit vlerësohet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë në nivel departamenti. Në përfundim të vitit akademik, grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti plotëson raportin e vetëvlerësimit të programit të studimit ku jepen të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshëm të realizuar, planet për ndryshimet dhe përmirësimin në të ardhmen, feedback-u i marrë nga studentët, nga personeli akademik, të dhëna mbi ecurinë e studentëve (<i>Evidenca 6.8 “Rregullore e NJSBC”; Evidenca 6.7 “Modeli raporti vetëvlerësimi programi”</i>).</p> <p>Në dokumentin e strategjisë, institucioni ka parashikuar që raporti i vetëvlerësimit të programit të studimit, pasi administrohet nga NJSBC, përfshihet në raportin vjetor të vetëvlerësimit institucional ose në kuadër të riakreditimit (<i>Evidenca 6.4 “Strategjia për sigurimin e cilësisë”</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka parashikuar në aktet e brendshme instrumentet që do të përdoren për kryerjen e vlerësimit (<i>Evidenca 6.4 “Strategjia për sigurimin e cilësisë” – Instrumentet e matjes së cilësisë</i>).</p> <p>Në nenin 8 të Rregullores së NJSBC janë specifikuar dhe metodat për kryerjen e vlerësimit. Nenet 9 dhe 10 të së njëjtës rregullore përcaktojnë indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik (<i>Evidenca 6.8 “Rregullore e NJSBC”</i>). Instrumentet dhe metodat shërbejnë për hartimin e raportit vlerësues të programit të studimit dhe përmirësimit të tij, nëse rezulton e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Metodat e drejtpërdrejta përmenden në nenin 8 të Rregullores së NJSBC (<i>Evidenca 6.8</i>):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare; 2. Dëgjime në auditor; 3. Vlerësimi me nota/pikë; 4. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; 5. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); <p>Vëzhgimet gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e</p>	<p>Metodat e tërthorta përmenden në nenin 8 të Rregullores së NJSBC (<i>Evidenca 6.8</i>):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetësorë me studentët që ndjekin programet e studimeve (<i>Evidenca 3.1 “Pyetësori”</i>);

intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program	2. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; 3. Fokus grupe (<i>Evidenca 3.2 "Shkresë fokus-grupet"</i>); Intervista.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Institucioni ka hartuar politikat e nevojshme lidhur me figurat që përfshihen në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë (<i>Evidenca 6.4</i>).</p> <p>Në këtë proces janë përfshirë njësitë bazë, stafi akademik, por dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve. Gjithashtu, në këtë proces është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, neni 6 i Rregullores së NJSBC (<i>Evidenca 6.8</i>), një konsulent juridik (<i>Evidenca 6.5.a</i>) dhe një konsulent për përmirësimin dhe zhvillimin e kurrikulave (<i>Evidenca 6.5.b</i>).</p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>Institucioni, në vijim të parashikimeve ligjore të aplikueshme, ka përcaktuar drejt rrethit e përgjegjësive e detyrave që duhet të përmbushen nga personat e angazhuar në sistemin e brendshëm të cilësisë, të nivelit bazë dhe institucional. Detyrat dhe përgjegjësitë janë përmendur në nenet 66-67 të statutit, nenet 13 e 14 të Rregullores institucionale si dhe në Rregulloren e NJSBC e strategjinë përkatëse (<i>Evidenca 1.4; Evidenca 1.2; Evidenca 6.8; Evidenca 6.4</i>).</p> <p>Në nivel departamenti të këtij programi studimi, përcaktimi është bërë në nenin 33 të Rregullores së programit (<i>Evidenca 1.5</i>).</p> <p>Nga shqyrtimi i rregullimeve të brendshme konstatohet që, formalisht, ushtrimi me përgjegjësi i detyrave në drejtim të sigurimit të cilësisë, është i garantuar.</p>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik,	<p>Në përputhje me rregullimet e bëra nga statuti i AU, në rregulloren e NJSBC janë përcaktuar: anëtarët e Komisionit për Vlerësimin Institucional, pesë të tillë, nga të cilët 4 anëtarë zgjidhen nga stafi akademik, kurse anëtari i pestë është student. Studentët janë të përfshirë nga NJSBC dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm (<i>Evidenca 6.8</i>).</p>

<p>ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p><i>“Rregullore e NJSBC”, nenet 2 dhe 6). Nga dokumentacioni nuk rezultojnë të dhëna konkrete mbi studentët pjesëmarrës nga ky program studimi, Master Shkencor në Shkenca Juridike, në këtë proces.</i></p> <p>Sikundër rezulton nga neni 3 i rregullores së NJSBC dhe nga neni 33 i rregullores së programit, në këtë proces njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë vepron në bashkëpunim me strukturat administrative të IAL si dhe me personelin ndihmësakademik (Evidenca 6.8; Evidenca 1.5).</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas përcaktimeve në rregullore, vlerësimi i brendshëm i cilësisë konceptohet dhe zbatohet mbështetur në standardet profesionale, duke zbatuar parimin e pavarësisë institucionale. Pasur parasysh dhe qëllimet e vlerësimit si dhe mënyrat e marrjes dhe administrimit të të dhënave, procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk synon të krijojë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve (Evidenca 6.8 “Rregullore e NJSBC”). Ky fakt nuk rezultoi as gjatë takimeve me grupin e pedagogëve dhe të studentëve në institucion (Evidenca shtesë “Minutat e takimit”).</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Sipas nenit 6 të rregullores së NJSBC, kur e sheh të arsyeshme, NJSBC, për çdo vlerësim që organizon në nivel institucional, mund të ftojë dhe një ekspert të jashtëm në përbërje të grupit të vlerësimit të brendshëm (Evidenca 6.8 “Rregullore e NJSBC”). Bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm rezulton dhe në dokumente të tjerë, ku del të jetë angazhuar një konsulent juridik (Evidenca 6.5.a) dhe një konsulent për përmirësimin dhe zhvillimin e kurrikulave (Evidenca 6.5.b).</p> <p><i>GVJ e sheh të arsyeshme të sugjerojë që, në hartimin e raportit të vlerësimit, të angazhohet dhe një përfaqësues nga njëri prej institucioneve të bashkëpunimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	


<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme rregullatore të AU, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo i interesuar. Sipas përcaktimeve të nenit 67/6 të statutit të AU dhe nenit 6/7 të rregullores së NJSBC, të dhënat, raportet përfundimtare të ZSBC, publikohen në faqen zyrtare të AU (Evidenca 1.4; Evidenca 6.8).</p>




	Raportet në fjalë gjenden në faqen elektronike të institucionit https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise .			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm, Kodin e Etikës të AU dhe me aktet rregullatore të brendshme. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të dhënave të përshkruara në raportet e publikuar në faqen zyrtare të AU si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cenuar liria dhe etika akademike apo të jenë cenuar të dhënat personale (<i>Evidenca shtesë 6; Evidenca shtesë 7.a; Evidenca R.2</i>). Qëllimi i vlerësimit është paraqitja e të dhënave të sakta mbi programet e studimit dhe përmirësimi i këtyre të fundit.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni i përdor të dhënat që dalin nga vlerësimi i stafit akademik në funksion të rritjes së cilësisë së procesit akademik, por jo vetëm. Të gjitha të dhënat që dalin nga pyetësorët, anketimet, etj., shërbejnë për hartimin në vijim të planit të masave që duhen marrë në vijim nga strukturat drejtuese të universitetit në rang fakulteti dhe në rang institucional (<i>Evidenca 6.8 "Rregullore e NJSBC" nenet 3/6, 6/6 dhe 7; Evidenca 6.4 "Strategjia për sigurimin e cilësisë"</i>).			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përfshirja e rregullimeve specifike mbi mënyrën e administrimit të të dhënave në rrjedhim të veprimtarive që monitorojnë vlerësimin e cilësisë nga ana e institucionit, dëshmon rëndësinë që universiteti i kushton këtij procesi. Sipas nenit 4 të rregullores së NJSBC, nëpërmjet procesit vlerësues synohet të përcaktohet niveli i cilësisë së arritur, evidentimi i praktikave pozitive, përmirësimi, ndryshimi dhe promovimi i zhvillimeve pozitive, marrja e vendimeve efikase (<i>Evidenca 6.8</i>). Institucioni ka parashikuar procedura të hollësishme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë (<i>Evidenca 1.1 "Strategjia e zhvillimit institucional 2017-2022", pika 4; Evidenca 6.4 "Strategjia për sigurimin e cilësisë"</i>).			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Në fillim të çdo viti akademik, institucioni mundëson në javët orientuese dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm, informimin e personelit akademik, administrativ, të studentëve, mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimin e programeve të studimit, gjithashtu dhe mbi vlerësimin institucional (<i>Evidenca 1.5, neni 31</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI				X
--	--	--	--	---



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Albanian University”

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Syllabus-et për secilën lëndë janë në përputhje me programin e studimit dhe janë pasuruar në drejtim të temave që trajtohen.
2. Institucioni ka ndërmarrë organizimin e disa aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe boton revistën periodike “Optime”, ku mundëson botimin e punimeve/artikujve të personelit akademik e më gjerë.
3. Institucioni ka arritur të përshtasë punën e stafit akademik dhe administrativ me gjendjen e krijuar për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 si dhe të sigurojë mësimdhënien në platformat elektronike dhe komunikimin me studentët edhe në distancë.

Pika të dobëta:

1. Programi nuk ka ofertë akademike në gjuhë të huaj.
2. Marrëveshjet e bashkëpunimit mbeten të kufizuara.
3. Në institucion mungon një kod etike apo materiale orientues në këtë aspekt.
4. Vihet re mungesa e teknologjisë në parandalimin e plagjaturës.

Rekomandime:

1. Të shtohet oferta akademike në gjuhë të huaj në përputhje me nivelin e programit të studimit dhe në funksion të ndërkombëtarizimit të programit.
2. Të ulët mbingarkesa mësimore për disa anëtarë të stafit akademik, sidomos kur këta të fundit kanë edhe funksione administrative
3. Rekomandohet të analizohet vlefshmëria dhe efektshmëria e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.
4. Të hartohet një kod etike që të orientojë sjelljet e mira në të gjitha aspektet akademike.
5. Institucioni të krijojë mundësi për të verifikuar nëpërmjet programeve dhe mjeteve teknologjike parandalimin e plagjaturave.
6. Rekomandohet mbështetja e studentëve në funksion të organizimit të konferencave shkencore si edhe aktiviteteve të tjera akademiko-shkencore.



7. Shtimi i marrëveshjeve me IAL të huaja, të cilat do të ndihmonin kualifikimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik dhe atij mësimor-shkencor, në përputhje me drejtimet e studimit të këtij programi studimi.
8. Të realizohet abonimi në një bibliotekë elektronike, të specializuar në fushën e së drejtës, e cila do të përmbushte më mirë plotësimin e qëllimeve të programeve të studimit që ofrohen nga departamenti i shkencave juridike të AU.
9. Të përcaktohen saktë procedurat e ftesës ndaj personelit akademik të huaj dhe studentëve të huaj për pjesëmarrje në veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle program Master of Science in "Legal Sciences" with directions: a. Public and administrative law b. Private law c. Criminal law, offered by the Private University "Albanian University"

Strengths and affirmations:


1. Syllabuses for each subject are in accordance with the study program and are enriched in terms of topics covered.
2. The institution has undertaken the organization of several national and international scientific activities and publishes the periodical magazine "Optime", which enables the publication of works / articles of academic staff and beyond.
3. The institution has managed to adapt the work of the academic and administrative staff to the situation created due to the pandemic caused by Covid-19 as well as to provide teaching on electronic platforms and communication with students even at a distance.

Weaknesses:

1. The program has no academic offer in a foreign language.
2. Cooperation agreements remain limited.
3. The institution lacks a code of ethics or guidance material in this regard.
4. There is a lack of technology in preventing plagiarism.

Recommendations:

1. To increase the academic offer in foreign languages in accordance with the level of the study program and in view of the internationalization of the program.



2. To reduce the teaching overload for some members of the academic staff, especially when the latter also have administrative functions
3. It is recommended to analyze the validity and effectiveness of cooperation agreements in order to implement the study program.
4. Develop a code of ethics to guide good behavior in all academic aspects.
5. The institution to create opportunities to verify through programs and technological tools the prevention of plagiarism.
6. It is recommended to support students in order to organize scientific conferences as well as other academic-scientific activities.
7. Adding agreements with foreign HEIs, which would help the further professional qualification of the academic and teaching-scientific staff, in accordance with the study directions of this program.
8. To subscribe to an electronic library, specialized in the field of law, which would better meet the goals of the study programs offered by the department of legal sciences of AU.
9. Precisely define the procedures for inviting foreign academic staff and foreign students to participate in research and teaching activities.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al